

Titulli: Demografia e Viseve Shqiptar në Greqinë e Veriut
(*Maqedoninë greke dhe Trakia greke)*

Autor: Arben P. LLALLA
Redaktor: Teuta LLALLA
Lektor: Besim DOGANI

Radhitja kompjuterike: Ramiz ILJAZI
Botues: Copyright © Autori
Shtypshkronja: LUMA, Korrik, 2013, Tetovë
Tirazhi: 300 copë

Ndalohet ribotimi, riprodhimi, i plotë ose i pjesshëm, në mënyrë të përmbledhur ose të perifrazuar i përmbajtjes së librit me çdo lloj mënyre, mekanike, elektronike, fotokopjimi etj., pa marrë më parë lejen me shkrim nga autori. Ligji 2121/1993 dhe rregullat e të Drejtës Ndërkombëtare.

LLALLA, Arben P.
Demografia e viseve shqiptar në Greqinë e veriut: (Maqedoninë greke dhe Trakia greke) / Arben P. Llalla. - Tetovë: Luma grafik, 2013th - 188 p. : Illustration. , 24 cm

Footnotes to the text. - Bibliography: p. 169-184

Librin ia kushtoj bashkëshortes time Teutës, pa ndihmën, mirëkuptimin dhe këmbënguljen e saj ky libër nuk do të botohej.

Autori i librit në kishën e Shën Akilit që gjendet afër fshatit Psaradhes, Greqi, Shkurt 2002

PARATHËNIE

Shqiptarët që banojnë në Greqi që nga koha e lashtë dhe që janë shtetas të shtetit grek, ndahen në dy grupe: arvanitasit dhe ata që grekët i thërrasin allvanos. Strukturat greke qëllimisht kanë bërë ndarjen e shtetasve shqiptarë të Greqisë në dy grupe për të dëshmuar që ata nuk kanë lidhje me njëri-tjetrin. Shqiptarët me emrin Arvanitas banojnë në zonat e qyteteve të Greqisë që në kohërat antike, atje ku kanë banuar pellazgët dhe kur themi pellazgët kuptojmë stërgjyshërit e shqiptarëve. Ndërsa ata që njihen me emrin allvanos banojnë në krahinën e Çamërisë: Janinë, Gumenicë, Korfuz, Artë, Prevezë, etj., në kufirin e sotëm shqiptaro-grek, Follorinë, Kostur dhe deri në Edesë. Më tej këta shqiptar i kemi në kufirin greko-turk në zonën e quajtur Trakia - Evros. Në të gjitha këto zona që përmendëm shqiptarët thirren allvani, allvanos sepse sipas dokumenteve historike që njohim kanë ardhur në këto zona pas shek. XV. Por përse disa allvanos e disa arvanitas, kur këta flasin në rrethin familjar të njëjtën gjuhë, kanë të njëjtat zakone e tradita, këndojnë të njëjtat këngë?

Mendoj që ndarja e emërtimeve të shqiptarëve të Greqisë në arvanitas dhe allvani, ndoshta është bërë sepse kur Greqia e shpalli Pavarësinë pas vitit 1821 jashtë saj mbetën shumë ishuj dhe territore të tjera si krahina e Çamërisë që banohej me shumicë dërrmuese nga shqiptarët ortodoksë dhe mysliman, pjesë nga Maqedonia si qytetet e Kosturit, Follorinës, Edesa, Dhramës, Selaniku e deri në Evros. Pas themelimit të shtetit grek këto qytete dhe fshatra njiheshin si territore që i përkisnin Perandorisë Osmane. Por mund të jetë edhe një variant për të dalluar shqiptarët (arvanitasit) vendas që

në kohën antike dhe shqiptarëve (allvanosët) që kanë emigruar valë - valë pas pushtimit osman të Ballkanit. Po të bëjmë një vështrim, shqiptarët që njihen me emrin arvanitas banojnë në qytetet e lashta të Greqisë, në ujdhesat që janë përshkruar edhe në librat e shkrimtarëve dhe historianëve antik. Ndërsa shqiptarët që njihen me emrin allvani banojnë në pjesët që i përvetësoi Greqia pas vitit 1878, pra në Çamëri, Maqedoninë e Egjeut dhe deri në lumin Evros. Si do që të jetë, arvanitasit dhe allvanosët flasin të njëjtën gjuhë shqipe, ruajnë të njëjtat tradita dhe zakone.

Me shpalljen e pavarësisë së Shqipërisë në nëntor 1912 shqiptarët e Greqisë që jetonin në zonat nën pushtimin turk u quajtën allvanos (shqiptar) dhe jo arvanitas. Kjo besoj se duhet të jetë ndarja e emërtimeve Arvanitas dhe Allvani nga ana e grekëve, por edhe nga vetë arvanitasit dhe allvanosët. Historianë të ndryshëm grek dhe shqiptar në librat e tyre i quajnë allvanosët e Evros herë arvanitas e herë allvanos. Por vetë këta qytetar grek me origjinë shqiptare pretendojnë se janë shqiptar me rrënjë nga Korça, Kolonja, Bithkuqi(Vithkuqi), etj.

Në fillim të vitit 1913 e deri më 1945, kur u bë spastrimi etnik i Çamërisë nga popullsia etnike shqiptare, qytetet dhe fshatrat në fjalë ishin nën shtypjen shtetërore greke për t'u larguar nga Greqia ose për t'u deklaruar grek dhe jo më shqiptar. Shumë prej shqiptarëve nga Korfuzi, Follorina e deri në kufi me Turqinë zgjodhën rrugën e mërgimit për në Turqi. Një pjesë e tyre erdhi në Shqipëri dhe një grup tjetër u asimilua ndër vite.

Nga viti 1912-1924, në shtëpitë e shqiptarëve, turqve, myslimanëve të tjerë dhe bullgarëve të përzënë nga Greqia u vendosën refugjatë të ardhur nga Azia e Vogël. Këta refugjatë shteti grek qëllimisht i vendosi në zonat e banuara në shumicë jo-greke si në Atikë-Beoti ku banojnë arvanitasit, në zonën e Maqedonisë ku banonin shqiptarë, bullgarë, turq, hebrenj dhe

në Trakia, me qëllim që me kalimin viteve të bëheshin ndryshimet gjuhësore dhe kulturore, pra atje ku grekët ishin pakicë me ardhjen e refugjatëve do bëheshin shumicë. Sipas statistikave numri i refugjatëve të ardhur në tërë Greqinë pas vitit 1912, ishte 1.221.849 njerëz, rreth 20% të popullsisë së atëhershme që jetonte në Greqi. Nga këta refugjatë 638.253 prej tyre u vendosën në Maqedoninë e Egjeut. Kjo shifër përbënte 45% të popullsisë së përgjithshme në këtë krahinë.

Në Trakinë greke u vendosën 107.607 refugjatë të cilët nuk u përfshinë si popullsi e shkëmbyeshme me detyrim. Ky numër i refugjatëve të ardhur kapte shifrën e rreth 35% të popullsisë së përgjithshme në Traki. Ndërsa Atiki-Beoti ku banojnë popullsi në shumicë arvanitase u vendosën 281.989 refugjatë, e thënë në përqindje rreth 28% e popullsisë së përgjithshme.

Pra, qëllimi ynë është që të njohim demografinë e fshatrave shqiptar në Maqedoninë e Egjeut dhe të Trakisë greke, duke përjashtuar fshatrat shqiptar në krahinën e Çamërisë dhe në ato vendbanime ku banojnë arvanitasit. Në këtë libër do të sjellim të dhëna shkencore në bazë të statistikave të udhërrëfyesve të huaj të shek. XIX dhe XX, për banorët, etnitetin dhe besimin fetarë të fshatrave ku shqiptarët kanë jetuar dhe jetojnë me popullsitë e tjera. Një pjesë të këtyre qyteteve dhe fshatrave i kam vizituar gjatë viteve 1991-2004, kur kam jetuar në Greqi. Kam takuar grekë me origjinë shqiptare me të cilët kuvendoja shqip. Prej tyre, mësova shumë gjëra interesante rreth jetës, këngëve, traditave dhe riteve të ndryshme që bëjnë të ruhen vlerat shpirtërore të një populli.

Në Shkurt të vitit 2002, vizitova disa fshatra rreth Liqenit të Prespës. Në një ishull të vogël gjendej kisha e Shën Akilit, e cila ndodhet 60 km nga Follorina dhe 65 km nga Kosturi. Në ishull jetonin rreth shtatë familje dhe për të shkuar atje duhet të kalosh mbi një urë lundruese 800 metra të gjatë.

Në këtë kishë ndodhej varri i Shën Akilit të cilin e solli mbreti bullgar Samueli nga Larisa. Natën e kalova në fshatin Psaradhes, i vetmi fshat grek që laget nga ujërat e liqenit të Prespës së Madhe ku jetonin diku 50-60 banorë, shumica pleq të cilët dinin të flisnin greqisht, bullgarisht dhe shqip.

Kohën që jam marrë për të shkruar këtë libër ka qenë shumë e vështirë për mua duke pasur parasysh vendin dhe vitet ku jetojmë. Megjithatë edhe në kushte të vështira mendoj se kam sjellë për lexuesit një libër që do t'u shërbejë për të njohur demografinë e fshatrave shqiptar në Maqedoninë e Egjeut dhe Trakinë greke. Shpeshherë këtyre fshatrave përveç se u janë ndërruar emrat, disa herë ju ndërrohen edhe kufijtë bashkiak apo komunal. Besoj se këto ndërrime të shpeshta janë bërë për të çorientuar studiuesit që merren me studime rreth demografisë së fshatrave në Greqi, por edhe banorët që në thellësi të shpirtit të tyre ndihen me kombësi jo-greke, të mos jenë të grupuar në masë të madhe.

Jam munduar të jem sa më objektiv për të thënë dhe mbrojtur të vërtetën e këtyre fshatrave dhe banorëve të tyre, atë të vërtetë që të gjithë ne dëshirojmë ta dëgjojmë, ta shohim e ta prekim, por e vërteta rrallë herë pranohet ashtu siç është sepse ajo mund të na duket e hidhur dhe të kundërshtojë interesat tona të ngushta kalimtare.

Qëllim i imi kryesor në këtë libër është të nxjerr nga pluhuri i harresës disa fakte, disa të dhëna që na bëjnë të mësojmë ku kanë jetuar dhe jetojnë njerëzit që në venat e tyre kanë gjak shqiptari, po ç'ka se për interesa ekonomike dhe nga presionet e ndryshme janë deklaruar prej shumë vitesh qytetar të një kombësie tjetër. E ardhmja nuk e dimë se çfarë befasish na ofron...

HYRJE

Historia shpeshherë na ofron fenomene për të cilat njeriu nuk gjen shpjegime. Ajo është një tunel i pafund, ku herë ka dritë për të shikuar të shkuarën dhe herë bënë errësirë. Në shumicën e këtyre rasteve historianët dhe studiuesit na i ofrojnë fenomenet dhe ngjarjet ashtu siç e kërkon politika fituese e kohës. Prandaj edhe në rastin e Maqedonisë Gjeografike shumë gjëra janë të pashpjegueshme dhe në shumicën e rasteve historia e saj herë është e ndritur dhe herë e errët nga luftërat e shumta. Për të edhe sot në shek. XXI ende ka mendime se si të ndahet ajo pjesë të vogël që ka mbetur me emrin Republika e Maqedonisë ose IJRM.

Në rastin e Maqedonisë Antike, historia është burimi i konflikteve për të drejtën e trashëgimisë së saj. Kjo gjë, sot vazhdon të shfrytëzohet për të legjitimuar projektet politike dhe qëndrimin sa më gjatë në pushtet të atyre që çirren si trashëgimtarë të drejtpërdrejtë të kombit të lashtë maqedonas dhe të Aleksandërit të Madh.

Që në kohët e lashta Maqedonia gjeografikisht ka pësuar vazhdimisht ndryshime duke përfshirë me këtë emër, shtrirje të ndryshme gjatë periudhave historike. Pra, emri Maqedonia Gjeografike që nga kohët e lashta e deri më sot ka pësuar tkurrje duke e humbur madhështinë e saj. Pretendimet për emrin Maqedoni dhe historinë e saj që nga koha antike vazhdojnë të sjellin probleme historike dhe territoriale ashtu si në shekujt e mëparshëm. Prej kaq vitesh me emrin Maqedoni kemi tre territore: 1). Maqedonia e Egjeut, greke, 2). Maqedonia e Pirinit, bullgare, 3). Republika e Maqedonisë (Maqedonia e Vardarit) që është themeluar nga Tito më 1945,

ku jetojnë rreth 2 milion banorë të etnive të ndryshme, pra një shtet shumë etnik.

Thuhet se shteti me emrin Maqedoni është themeluar nga fundi i shek. IX para K., duke e zgjeruar hapësirën që shënonte emri i tij. Nën mbretërimin e Filipit II, atit të Aleksandërit të Madh, ajo u shtri nga Mali Orbel te Mali Olimbit dhe nga vargmali i Pindit deri te lumi Nestos. Në epokën romake Maqedonia u përfshi në *Illyricum*. Dhe kjo ndarje nuk na duket arbitrare; ajo shpjegohet nga fakti se emri *Illyricum* përfshinte një popullsi homogjene, të përbërë në atë kohë vetëm nga pellazgë, që mbanin emra të ndryshëm si maqedonas, epirotë, albanë (toskë, etruskë dhe gegë), dalmatë, dhe të tjerë ilirë, dhe flisnin po atë gjuhë: pellazgjishten ose shqipen.[1]

Në shek. I-II të erës sonë ekzistonin dy provinca romake me të njëjtin emër-Maqedonia e Parë (Macedonia Prima) me qendër Selanikun dhe Maqedonia e Dytë (Macedonia Secunda) me qendër Durrësin. Te vepra e gjeografit Aleksandrinë të shek. II, Klaud Ptolemeu (Geographia, Libri 12), Maqedonia e Dytë, pra provinca e Durrësit shtrihej në veri deri në derdhjen e lumit Drin, në lindje përtej Liqenit të Ohrit deri te qyteti Heraklea i Lynkestëve, kurse në jug, përtej Vlorës deri në malet Akroceraune të Himarës. Më vonë, Maqedonia e Dytë u quajt provinca e Epirit të Ri (Epirus Nova) me qendër Durrësin dhe përfshinte, sipas njoftimeve që ndeshim në Notitia Dignitatum (III, 13) edhe një pjesë të Maqedonisë historike (Epirus nova et pars Macedonia Salutaris). Për këtë arsye, shpeshherë në burimet historike mesjetare, savante europiane, Arbëria është identifikuar me Maqedoninë (Albania sive Macedonia) dhe shqiptarët e provincës së Durrësit, janë quajtur maqedonas. Përkundrazi, banorët sllavë pasi u vendosën në Maqedoni në fillim u quajtën skllavin dhe më vonë bullgarë, kurse vendi i

[1] Robert d'Angely, *Enigma*, Tiranë, 1998, fq.246-247

tyre në fillim Skllavini dhe më vonë Bullgari. Është e vërtetë se herë pas here emërtimi gjeografik Maqedoni është zhvendosur, por zhvendosja ka ndodhur kryesisht drejt Lindjes deri në Selanik e përtej dhe asnjëherë drejt veriut, në kurriz të provincës së Dardanisë.[2]

Me Maqedoninë e vjetër, lidhen vetëm shqiptarët. Emri Maqedoni nuk është me prejardhje sllave në masën që nuk ka origjinë greke. Personazhi eponim i Maqedonisë, Maqedoni (emrin e të cilit e mban Maqedonia) është bir i "Ilirit Lykaon"). (p. Grimal, 1951), pra bir i pellazgëve, emrin e të cilit mban populli pellazg.

Ajo që bie në sy, sipas të gjitha burimeve të mitologjisë greke, pellazgët nuk kanë kurrfarë lidhje etnike me helenët apo me ndonjë popull tjetër. Kurse ilirët lidhen aq shumë etnikisht me pellazgët, sa disa autor marrin shpesh pellazgët për ilirë, ose anasjelltas.

Grekët e parë, kur erdhën në Ballkan (shek. XVIII-XVII para e. s.), e kanë gjetur vendin të banuar nga popujt joindoevropian, të mbizotëruar nga pellazgët. Emrat e qyteteve si Athina, Teba, etj., dhe toponime tjera të Maqedonisë, si dhe të krahinës që më vonë ka marrë emrin Heladë, apo Greqi, shpjegohen jo vetëm me mitologjinë dhe letërsinë e Greqisë së vjetër, por edhe me mitologë, mitografë dhe historianë modern.

Sipas albanologëve të mëdhenj, ndër të cilët shquhen Taul Kretschmer, Norbert Jokl dhe Eqrem Çabej, etj; Maqedonia bën pjesë në territorin e formimit të gjuhës shqipe. Ndër burimet e pakta historike mund të zgjerohet rrethi i të dhënave të duhura me të dhënat toponimike.

Ndryshimi më i dukshëm ndër popujt e Maqedonisë vihet re mes shqiptarëve dhe sllavëve maqedonas: ndërsa të parët

[2] Grup autorësh, punimi i Kristo Frashërit, *Maqedonia Shqiptare në dritën e teksteve dhe dokumenteve historike,* vëllimi parë, Tetovë, 2009, fq.27-28

gëzojnë lidhje etnike me pellazgët, të cilët kanë populluar Maqedoninë që në mijëvjeçarin e tretë p.e.s., sllavët janë dukur në veri të Rumanisë dhe të Hungarisë në shek. VI-VII p.e.s., dhe kanë zbritur pas disa shekujsh deri në Maqedoni.[3]

Shqipja qe gjuha amtare e Aleksandërit të Madh që pushtoi botën dhe e Pirros së Epirit, një nga gjeneralët më të mëdhenj që përmend historia, përballues i fundit i ushtrive pushtuese Romake. Një tragjedi, përtej përfytyrimit të tragjedisë, është kjo që një racë e vjetër dhe e fortë erdhi në një gjendje kaq të keqe dhe mizore, gjë e cila shihet si skandal i qytetërimit Evropian. Nuk është për çudi që otomanët nuk lejuan ndonjë gërmim në tokën Shqiptare, sepse ajo mund t'i sillte ndërmend këtij populli lulëzimin e parë.[4]

Me pushtimin e Ballkanit nga Perandoria Osmane ndryshoi edhe harta etnografike e Maqedonisë. Shqiptarët në rreth 70% përqafuan islamin, ndërsa ata shqiptar që mbetën ortodoks dhe katolik mbetën në mëshirën e fatit përballë shtypjeve për asimilim nga grekët dhe sllavët. Turqia Osmane iu dha shumë të drejta grekëve, serbëve, bullgarëve, vllehve, hebrenjve, të cilët i përkisnin besimit fetar ortodoks. Ata gëzonin të drejtën e shkollimit në gjuhët e tyre amtare dhe të drejtën e gjuhës në kishë, vetëm shqiptarëve nuk iu dha e drejta e hapjes qoftë të ndonjë shkolle në gjuhën shqipe edhe pse ata ishin ushtarë të denjë të Perandorisë Osmane.

Rritja e nacionalizmit Evropian të shek. XVIII, çoi në zgjerimin e Greqisë së Madhe në Maqedoni (Megali Idhea). Shtylla kryesore e saj gjatë shekujve të sundimit osman ishte popullsia greke në Maqedoninë Jugore. Nën ndikimin e shkollave greke dhe Patriarkanës së Stambollit (Kostandinopojës), grekët filluan asimilimin e ortodoksëve sllavë, shqiptarë dhe vllehve në territoret urbane duke ushqyer

[3] Po aty, punimi i Arsim Spahiut, fq.47-49

[4] George Fred Williams, *Shqiptarët*, Tiranë, 1934, Fq.6

tek këta të qenit qytetar me kulturë greke. Gjuha greke u bë një simbol i qytetërimit dhe mjeti themelor i komunikimit ndërmjet ortodoksëve. Procesi i greqizmit ishte përforcuar gjithnjë e më shumë pas heqjes së Kryepeshkopatës Bullgare të Ohrit në vitin 1767. Megjithatë varfëria e fshatarësisë ortodokse dhe mungesa e udhëzimeve të përshtatshme në fshatrat e Maqedonisë u shmang mundësia e greqizmit të plotë të këtij rajoni.

Gjatë katër shekujve të parë të sundimit osman, sllavët në Maqedoni vazhdonin ta quanin veten bullgarë dhe u përshkruan si të tillë nga historianët osmanë. Gjuha sllave u ruajt në mjediset e disa manastireve duke qëndruar e pathyeshme përballë propagandës fetare ortodokse grek. Epërsia e bullgarizimit të Maqedonisë filloi pas themelimit të Patriarkanës bullgare më 1870.

Procesi i greqizmit në fillim të shek. XIX, kishte prekur vetëm një pjesë të kufizuar të popullsisë. Rilindja Bullgare në mesin e shek. XIX ishte shumë e shkurtër për të formuar një ndërgjegje të plotë bullgare përballë përfitimeve financiare të dhënë nga propaganda greke dhe serbe. Shpeshherë fshatra të tëra e ndryshonin kombësinë dhe shtetësinë e tyre në greke, serbe dhe bullgare në pak vite.

Shqetësimet për Maqedoninë dhe banorët e saj, u shfaqën dukshëm nga sllavët pas afrimit të marrëdhënieve midis Rusisë e Serbisë dhe pas fillimit të rilindjes kombëtare bullgare. Tendencat e dy qeverive, bullgare dhe serbe, u përplasën mbi terrenin perëndim-verilindje të asaj që ata e quanin Maqedoni, domethënë në krahinat lindore dhe verilindore të Shqipërisë. Pra, fronti i një lufte gjithnjë e më të ashpër sapo kishte filluar, e shoqëruar me propagandë, literaturë dhe etnografi të Maqedonisë.

Nga fundi i shek. XIX Greqia, Serbia dhe Bullgaria financonin njerëz të cilët merreshin për të përpunuar të dhëna rreth gjetjeve të rrugëve nga do të kalonte ushtria, fshatrat,

numrin e banorëve, etninë dhe besimin fetar të tyre. Pra, parapërgatitje të terrenit për luftën që do ti shpallej Perandorisë Osmane me qëllim për zgjerimin e territoreve të tyre në të ardhmen. Këta misionar mundoheshin që të ulnin numrin e popullsive të tjera dhe të rritnin numrin e popullsisë së tyre, pra gara për të paraqitur sa më shumë banorë të etnisë serbe, bullgare dhe greke sapo kishte nisur.

Në vitin 1878, Rusia pushtoi Turqinë dhe ndaloi në dyert e Stambollit. Traktati i Shën Stefanit u bë në mes të dy ndërluftuesve, e me të cilin mjeshtërisht Rusia, për të mirën dhe përdorimin e vet krijoi një shtet të madh bullgar, që nga ana Jugore do të shtrihej deri në detin Egje duke përfshirë edhe portin e Selanikut. Kjo shkaktoi mbledhjen e shpejtë të fuqive Evropiane të cilët bënë traktatin e Berlinit. Ky traktat ndaloi formimin e shtetit Bullgar të projektuar nga Rusia dhe vuri në heshtje kërkesat e saja për të pasur një port në detin Mesdhe.

Bullgarët, duke parë që nuk mund ta gllabëronin direkt Maqedoninë, i dhanë përparësi tendencës së shkëputjes dhe të autonomisë në mjedisin maqedonas dhe veçanërisht sllav-folës. Të njëjtën gjë bënë edhe serbët, me shpresë se duke u bërë autonome Maqedonia, dhe duke u caktuar si gjuhë zotëruese, idioma e saj, ai shtet autonom apo i pavarur që do të krijohej, shpejtë a vonë do të ishte nën ndikimin e madje nën zotërimin e tyre. Sipas tyre, e rëndësishme ishte të mos i bashkohej Greqisë, sepse në këtë rast nuk do kishte asnjë shpresë për ndonjë dalje në Egje dhe në Mesdhe.[5]

Serbia, Rumania dhe Mali i Zi u shpallën shtete të pavarura. Një hartë e kohës së atyre viteve tregon se traktati e la një copë të Ballkanit akoma nën sundimin turk, e cila shtrihej prej Adriatikut deri në Stamboll dhe përmblidhte Bosforin, Selanikun, Maqedoninë dhe Shqipërinë. Skllavëria dhe robëria

[5] Aristidh Kola, *Greqia në Kurthin e Serbëve të Milosheviçit*, Fier, 1998, fq.33

e të shkretës Shqipëri nuk u bisedua, kjo ishte viktima e parimit të kësaj diplomacie të Evropës.[6]

Vendimi për të lënë Maqedoninë Berlinit brenda kufijve të Perandorisë Osmane në Kongresin e u kthyen shpejt në zonën e kontestit mes Serbisë, Greqisë dhe Bullgarisë. Lufta e pamëshirshme, e qasjeve propagandistike nxitën më shumë dhunën dhe pamundësinë e fuqive të mëdha për të siguruar një zgjidhje të kënaqshme dhe përfundimtare për territorin e Maqedonisë, ndryshe nga shumica e territoreve të diskutueshme të cilat u zgjidhën përfundimisht.

Maqedonia ishte një çështje e bindjeve politike dhe përfitimeve financiare, të asaj që u konsiderua si politikisht korrekte në kohë të caktuar. Shumë diplomatë dhe udhëtarët rusë e perëndimore kanë përcaktuar si maqedonas banorët sllav-folës, por duke shënuar se iu mungon një ndërgjegje kombëtare e përshtatshme.

Revista "National Geographic Magazine", e nëntorit 1912 do të shkruante për çështjen e Maqedonisë dhe popujt e saj. Luigi Villari, në këtë revistë do të shkruante "*Sikur popullsia e Maqedonisë të kish qenë homogjene, problemi i Maqedonisë do të ishte zgjidhur shumë kohë më parë, por përzierja e racave ka qenë një karakteristikë e dukshme e Gadishullit Ballkanik, dhe asnjë pjesë e saj nuk është më shumë se në Maqedoni. Maqedonia përbëhet nga tre vilajete; ai i Selanikut, Manastirit dhe Kosovës, dhe çështja maqedonase i referohet këtyre krahinave*".[7]

Në fillim të shek. XX, shtetet kombëtare të Bullgarisë, Serbisë dhe Greqisë luftonin për kontrollin mbi Maqedoninë, e cila asaj kohe ende ishte pjesë e territorit të Perandorisë Osmane. Pas pak kohe, këto shtete nisën Luftën e Parë

[6] George Fred Williams, *Shqiptarët*, Tiranë, 1934, fq.10

[7] *The National Geographic Magazine*, Washington, Novembre, 1912, fq.1118

Ballkanike (1912 -1913), duke e ndarë territorin e Perandorisë Osmane të Maqedonisë ndërmjet tyre. Maqedonia e Vardarit i takoi Serbisë, e Pirinit Bullgarisë, kurse e Egjeut i takoi Greqisë. E pakënaqur nga kjo ndarje, Bullgaria e shkaktoi, por edhe e humbi Luftën e Dytë Ballkanike (1913). Pas këtyre luftërave Bullgaria mundi të fitojë territoret e pjesës së Maqedonisë së Pirinit, por ajo humbi pjesët e Maqedonisë greke dhe të Trakisë që banoheshin në shekuj nga një popullsi e konsiderueshme bullgare.

Nga Marrëveshja e Bukureshtit Greqia doli e fituar sepse ajo bëri spastrimet etnike duke masakruar dhe larguar nga shtëpitë e tyre bullgarët, shqiptarët dhe myslimanët osman nga pjesa e Maqedonisë greke. Ajo përfitoi qytetin e Follorinës që njihej si qendër e banuar me popullsi bullgare dhe qytetin e Kosturit që njihej si qytet që banohej në shumicë nga shqiptarët. Qindra fshatra humbën identitetin e tyre duke iu ndërruar emrat dhe duke sjellë banorë të rinj nga Azia e Vogël. Greqia përfitoi edhe pjesën e Epirit shqiptar, Çamërinë, krahinë kjo historikisht e banuar nga një shumicë e popullsisë shqiptare myslimane dhe ortodokse.

Serbia përfitoi territore që banoheshin historikisht nga bullgarët dhe shqiptarët, serbët mundën të merrnin si plaçkë lufte qytetet e Manastirit, Ohrit, Strugës, Kërçovës, Dibrën, Shkupin dhe Prishtinë. Pas disa vitesh nga këto territore ata do të themelonin Republikën e Maqedonisë e cila prej shumë vitesh është bërë një problem ndërkombëtar midis Greqisë dhe sllavëve të kësaj republike për ekskluzivitetin etnik dhe historik të maqedonasve të lashtë.

Përpjekjet serbe në fillim të shek. XX vazhdonin propagandën dhe në veçanti puna e Jovan Cvijiç, kishte arritur të ushqente në mënyrë të vendosur konceptin e sllavëve maqedonas në opinionin publik Evropian dhe emri sllavo-maqedonas gjeti përdorim të gjerë në ato vite. Por edhe

bullgarët nuk kishin mbetur mbrapa me propagandën e tyre për popullsinë bullgare në Maqedoni. Studiuesit pro-bullgarë si H. Brailsford dhe N. Forbes argumentonin se sllavo-maqedonasit për nga kultura dhe gjuha janë bullgarë dhe jo serb.

Studiuesit sllavë dhe grekë që u morën me etnografinë e popullsisë së Maqedonisë Gjeografike të Perandorisë Osmane në shpërbërje nga viti 1880 e deri në përfundimin e luftërave Ballkanike dhe të Luftës së Parë Botërore, kanë përdorur haptazi trukun e vjetër duke i njësuar me vetëdije shqiptarët myslimanë si turq, ndërsa shqiptarët e krishterë si grek. Kjo metodë ishte mjaft e njohur për ato vite në Ballkan dhe qëllimi për ti identifikuar shqiptarët mysliman si turq kishte synim të përhap tezën se shqiptarët janë të huaj në Ballkan, ata janë të ardhur nga Azia, vend në të cilin duhet të kthehen përsëri pas shpërbërjes së Perandorisë Osmane. Ndërsa shqiptarëve ortodoks u mbetej vetëm rruga e asimilim në grek ose sllavë për të mbijetuar. Teoria që shqiptarët mysliman duhen përzënë për në Turqi deri diku u zbatua hapur në terren me nënshkrimin e Traktatit të Lozanës më 30 janar 1923, për shkëmbimin e popullsisë greke dhe turke, dhe kundrejt deklaratës së delegatit grek i cili tha se Greqia nuk kishte qëllim të kryente ndonjë shkëmbim të myslimanëve me prejardhje shqiptare që banonin në një rajon të papërcaktuar, mijëra shqiptar mysliman përfunduan dhunshëm në Turqi.

Më 17 dhjetor,(1923) Blinishti, shefi i sekretariatit të përhershëm shqiptar të akreditуar në Gjenevë, tha para Këshillit të lidhjes së Kombeve se prona e shqiptarëve myslimanë ishte konfiskuar, të korrat qenë rekuizuar, atyre u ishte ndaluar ta mbillnin drithin e tyre apo të shisnin a të jepnin me qira pronën e vet. Për të penguar konfiskimin e saj, refugjatët grekë ishin vendosur në shtëpitë e tyre dhe e drejta e votimit u ishte hequr. Prandaj Këshilli i Lidhjes së Kombeve vendosi të tërhiqte vëmendjen e Komisionit të Përbashkët mbi Shkëmbimin e

Popullsive Greke dhe Turke, duke kërkuar që ai të dëgjonte çdo dëshmi që qeveria shqiptare mund të dëshironte të paraqiste para tij.

Grekët, ishin të etur ta hiqnin qafe pakicën shqiptare myslimane, brenda kufijve të tyre - elementin shqiptar të krishterë, ajo do ta asimilonte në njëfarë shkalle në mënyrë që pretendimet e Shqipërisë për territorin shqiptar që ajo kishte marrë më 1913 mund të binin në heshtje. Turqia, që e kishte përkrahur shkëmbimin, ishte e etur të rimëkëmbte popullsinë e saj, të pakësuar nga lufta me Greqinë, dhe nuk pritej që ajo të refuzonte myslimanët, për më tepër, prona që ata linin pas, u bë një pasuri në llogari të saj me Greqinë.[8]

Komisioni i Lozanës përbëhej nga një grek, një turk dhe një asnjanës i cili mashtrohej shpeshherë nga dy anëtarët e komisionit. Kështu, qeveria shqiptare duke parë padrejtësitë për shkëmbimin e popullsisë shqiptare myslimane në grupin e popullsisë së shkëmbyeshme i bënte thirrje Këshillit të Lidhjes së Kombeve për futjen e një përfaqësuesi shqiptar në Komision. Kjo kërkesë nuk u morr parasysh dhe Greqia arriti të dëbojnë mijëra shqiptar mysliman nga shtëpitë e tyre për në Turqi.

Pak vite më vonë, më 1938, Turqia do të nënshkruante me mbretërinë e Jugosllavisë Konventën për dëbimin e shqiptarëve mysliman nga kjo mbretëri për në Turqi. Ata ranë dakord gjatë viteve të zhvendosen 40 mijë familje shqiptare nga Kosova, Maqedonia dhe Mali i Zi në zona të zbrazëta të Anadollit.

Si pasoja të pastrimit etnik afatgjatë dhe kolonizimit të hapësirave shqiptare në Ballkan, ka ardhur deri në ndryshime të rëndësishme në strukturën etnike të popullatës. Për shkak të zbatimit të masave të dhunës të grupeve etnike ndër vite raportet e etnive mbeten të tensionuara, veçanërisht ndërmjet vendaseve shqiptarë dhe kolonialistëve sllavë, serbë, malazezë,

[8] Joseph Swire, *Shqipëria, Ngritja e një Mbretërie*, Tiranë, 2005, fq.330-331

sllavo-maqedonas, që sollën deri në luftërat ndër etnike në vitin 1999 në Kosovë, 2000 Medvegjë-Bujanoc-Preshevë dhe 2001, në Republikën e Maqedonisë.

KAPTINA I

ORIGJINA ILIRE - SHQIPTARE E ALEKSANDËRIT TË MADH

Emri i Aleksandërit të Madh ende vazhdon të krijojë turbullira politike edhe sot, këtu e dymijë e dyqind vjet nga vdekja e tij duke bërë që politikat e vendeve të ndryshme të varen shpeshherë nga lavdia dhe emri i tij për ta privatizuar.
A ishte grek Aleksandri? Çfarë e lidhte atë, mbretin e Maqedonisë Antike me shqiptarët dhe grekët?

Disa pseudo historianë të fqinjëve tanë të afërt dhe të largët pretendojnë që Leka i Madh nuk ka prejardhje shqiptare. Por historianët e lashtë kanë lënë shënime që tregojnë se Aleksandri i Madh ishte i biri i mbretit të Maqedonisë Filipi II dhe i Olimbisë, një princeshë Ilire, e bija e mbretit të Epirit Neoptolemi I.

Shumë shkrues të historisë Antike ndër ta edhe babai i historisë greke Herodoti dhe Tukidi na lajmërojnë se Pellazgët (shqiptarët) janë popull para grekëve "proelinioi".

Filipi II

Filipi lindi në vitin 382 para K., nga një baba maqedonas dhe nënë ilire e cila quhej Euridikë nga fisi ilir i Lynkestëve. Lynkestët ishin ilirë, këtë na e dëshmojnë studiuesit dhe historianët antikë si: Livi, Plini, Straboini, Ptolemeu, etj.

Ilirët, Lynkestë, banoni përreth liqenit të Ohrit dhe kryeqytet kishin Manastirin e sotëm. Pra, vetë Filipi ishte gjysmë maqedonas dhe gjysmë ilir. Pas vdekjes së babait Amynta, Euridikja e dërgon Filipin në Iliri tek Lynkestët,dhe më tej në Tebë. Filipi pas disa vitesh bëhet mbret i Maqedonisë më 359 p. K. Filipi u martua me iliren Olimbi dhe nga kjo martesë do të lindte Kleopatra, Kynëna dhe Aleksandri, që do bëhej legjendë, një emër i madh që shpeshherë ndrit dhe shpeshherë errëson historinë e tij.
Filipi me të hipur në frontin e maqedonasve nënshtroi fisin e nënës së tij Lynkestët të cilët kishin udhëhequr politikën e maqedonasve. Më tej Filipi i drejtoi synimet e tij për të spastruar territoret e Maqedonisë nga kolonët grekë. Ai shtiu në dorë Selanikun, Trakinë, Skithinë, etj; duke zhdukur mbi 200 koloni greke.

Pasi Filipi pushtoi të tërë Greqinë, Demosteni i cili ishte oratori më i madh grek i quajtur edhe mbrojtësi i grekëve kundra maqedonasve në ligjëratën e tij të titulluar "FILIPIKA e Tretë" thotë: "**Filipi, jo vetëm që nuk është grek, edhe asnjë lidhje nuk ka farefis me grekët, por ai është një murtajë e ndyrë e Maqedonisë...**". Ndërsa Straboni shkruan: "**Maqedonasit janë quajtur si Paion**". Por nga historia kemi mësuar se në të vërtetë Paionët ishin ilirë[9].

Një nga dashnoret e Filipit e akuzoi Olimbinë se Aleksandri nuk ishte djalë i Filipit por, Olimbia e kishte me Amonin. Amoni ishte një gjarpër. Olimbia u fye rëndë nga kjo akuzë. Pasi Filipi e ndau Olimbinë, ajo bashkë me Aleksandërin shkuan për disa kohë të jetojnë në mbretërinë e Lynkestëve. Atëherë Filipi i shpalli luftë Lynkestëve, por gjatë betejës ai desh u vra. Më tej Filipi kërkoi që Aleksandri të kthehej në Maqedoni, por Aleksandri këmbëngulës dhe kokë shkëmb i vuri kusht që të kthehej edhe nëna e tij Olimbia dhe të

[9] Elena Kocaqi, *Roli Pellazgo-Ilir...*, Tiranë, 2007, fq.63

respektohej si mbretëreshë. Filipi e pranoi kushtin. Ai për tu afruar me fisin ilir të Olimbisë kërkoi që vajza e tij Kleopatra të martohej me mbretin e Epirit vëllanë e Olimbisë. Gjatë dasmës, Aleksandri në bashkëpunim me nënën e tij dhanë urdhër që Filipi të vritej. Gjatë dasmës një ushtar maqedonas i afrohet Filipit dhe i ngul thikën në zemër duke e lënë te vdekur në vend atë. Me ngjitjen e Aleksandërit në frontin e maqedonasve Olimbia e vret gruan e re të Filipit bashkë me fëmijët e saj.

Olimbia

Gruaja e Filipit dhe nëna e Aleksandrit të Madh Olimbia, vinte nga fisi i Ilirëve të Epirotëve. Olimbia ishte stërmbesë e mbretit të Mirmidonëve, Akilit, i cili u vra në luftën e Trojës. Pra Olimbia ishte e bija e mbretit të Epirit Neoptolemi I, i cili rridhte nga fisi i Pirro Neoptolemi, djali i Akilit. Pirro Neoptolemi pas luftës së Trojës u vendos në Toskëri duke themeluar mbretërinë e Epirit. Pirro Neoptolemi është stërgjyshi i Pirros së Madh që luftoi deri në Romë në shekullin III, përpara Krishtit. Olimbia dhe Pirro janë kushërinj të parë. Emri i vërtetë i Olimbisë ishte Mirtal, pra edhe kjo një fjalë shqipe e përbërë nga MIR-DAL. Në gjuhën shqipe shpesh herë shkronja T ngatërrohet me D, sikurse S me Z, P me B, etj. Më vonë Mirtali u quajt Olimbi, emër që ia vuri vetë Filipi. (Kjo fjalë rrjedh nga gjuha shqipe të cilën do ta shpjegojmë më poshtë). Olimbia ishte shumë e bukur me flokë të verdha, të dredhura e të gjata. Bukurisë së Olimbisë nuk i rezistoi Filipi i cila e la gruan e tij të parë që ishte ilire dhe quhej Audata.
Siç duket bukuria e veçantë, zgjuarsia e Mirtalisë ka bërë që më tej ajo të thirrej me emrin madhështor Olimbi.

Olimbia është një emër shqiptar që përbëhet nga bashkimi i fjalëve pellazge OLI dhe MBI[10]. OLI do të thotë: *TË GJITHË* dhe MBI, *MBI-SIPËR*. Emri OLIMBI është një emër që tregon madhështi. Lojërat më të mëdha në botë quhen Lojërat OLIMBIKE, mali më i lartë në Greqi quhet Mali i OLIMBIT. Pra, emri Olimbi ka kuptimin e madhështisë "MBI TË GJITHË".

Sot gjuhëtarët shqiptar e ngatërrojnë fjalën Olimbi me Olimpi. Fjala OLIMBI në greqisht shkruhet OLIMBI dhe shqiptohet OLIMBI. Shkronja MP në greqisht është B dhe kur ndodhen midis dy zanoreve shqiptohet MB. Gjuhëtarët shqiptar kanë bërë deri më sot transkriptim të fjalës greke OLIMBI, duke bërë që kjo fjalë të humbi kuptimin e saj që rrjedh nga gjuha shqipe (pellazge). Gjuhëtarët tanë me dashje ose pa dashje kanë bërë shumë gabime në disa fjalë shqipe duke i quajtur si fjalë të ardhura nga greqishtja, sllavishtja, latinishtja, etj. Por po të studiohet më thellë do kuptojmë se kemi fjalë të gjuhës shqipe të përvetësuara nga gjuhët e tjera.

Aleksandri i Madh

Plutarku për Aleksandërin e Madh shkruan se ai ishte biond, me një përskuqje të lehtë në faqe dhe në gjoks. Dua të shtoj se edhe Pirro i ynë i Epirit kishte një përskuqje në të tërë fytyrën e tij. Aleksandri nga pamja e jashtme i ngjante nënës së tij Olimbisë dhe dajallarëve që ishin nga fisi ilir i Epirit.

Filipi për të mësuar Aleksandërin në edukimin e tij mori dy mësues Leonidhën që ishte kushëri me Olimbinë dhe Lisimakun edhe ky nga krahina e Dodonës Pellazge.[11] Pra siç del nga historia me edukimin e Aleksandërit u morën dy

[10] *ALBANIA*, Tiranë, 24 Janar, 2007
[11] Edwin Jacques, *Shqiptarët*, Tiranë, 1996, fq.105

mësues ilirë. Më vonë Filipi solli edhe Stagjire me prejardhje shqiptare[12] i njohur me emrin Aristoteli, një filozof i zoti nga Selaniku, për ti mësuar Aleksandërit gjuhën greke, letërsinë e tyre, por edhe traditat dhe historitë e popujve të Azisë me qëllim që të njihte vendet që do të pushtonte pas disa vitesh.

Në moshën 18 vjeçare Aleksandri në krye të 2.000 kalorësve mposhti ushtrinë e Athinës. Mbas vrasjes së Filipit, Aleksandri në moshën 20 vjeçare bëhet mbret i Maqedonisë dhe i Greqisë në një moshë të re në verën e vitit 336 p. K. Në vjeshtën e vitit 335 para K. Aleksandri i Madh u kthye në Pellë për të përgatitur planin e tij të madh për të pushtuar Azinë dhe të shkatërronte perandorinë Perse. Gjatë udhëtimit të tij për në Azi bëri edhe një ndalesë të vogël në bregdetin e Trojës që tashmë ishte shkatërruar e tëra nga lufta dhjetëvjeçare midis Trojanëve dhe Akejve. Kur mbërriti në Trojë Aleksandri u mallëngjye. Librin më të dashur ai kishte ILIADËN dhe nëpërmjet saj kishte mësuar për Trojën dhe luftën e saj. Gjatë vizitës në Trojën e shkatërruar Aleksandri bëri fli në kujtim të mbretit të pafat të Trojanëve Priamit të cilin e kishte vrarë djali i Akilit, Pirroja. Por nga heronjtë e luftës së Trojës ai adhuronte Akilin, mbretin e Mirmidonëve që e kishte stërgjysh nga nëna.

Ishte mëngjesi i 3 qershorit ët vitit 323 p. K., kur Aleksandri ndjeu se kishte zjarrmi të brendshme, pasi bëri një banjë ai u shtri përsëri në gjumë. Kur u zgjua thirri të gjithë gjeneralët për planin e betejës, por pa se vetë ishte i pamundur. Për disa ditë rënkoi në shtrat nga temperatura e lartë dhe më 13 qershor vdiq në krevat i sëmurë. Kështu, mbreti i Maqedonisë që kishte mposhtur në fillim Greqinë dhe i kishte marrë emrin nuk mundi të realizonte ëndrrën e tij për të pushtuar tërë botën. Ai për dhjet vjet pushtoi pjesën më të madhe të saj, ndërsa stërgjyshit të tij Akilit me aleatë iu deshën dhjetë vite për të mposhtur Trojanët me dredhi.

[12] Robert d'Angely, *Enigma*, Tiranë, 1998, fq.244

Aleksandri vdiq, por mbeti gjallë emri, legjenda e tij. Lavdia e tij ndriçon e herë errëson dhe krijon probleme, dymijë e dyqind vjet pas vdekjes së tij

Sipas disa studiuesve të huaj Aleksandri i madhe quhej Meryamun Aleksandri, këtë mendim studiuesit e mbështesin në një mbishkrim që është gjetur në Egjipt.
Aty në një citim thuhej: "Meryamun setepenra Aleksandros".[13] Kjo është një dëshmi që tregon se emri Aleksandër është i mëvonshëm, ose më mirë të themi që është Nofk. Shpesh herë duhet të na punojë logjika e thjeshtë për të mësuar shumë të fshehta të njerëzve në kohën antike. Po ta ndajmë emrin ALEKSANDËR në tre pjesë do të lexojmë tre fjalë, A-LEKS-ANDËR, që do të thotë: A është fjala e sotme shqipe ËSHTË, LEKS që është emri LEK dhe ANDRA është një fjalë e vjetër pellazge që e përdorin ende shqiptarët, dhe do të thotë Ëndërr. Pra, emri ALEKSANDËR mund të shpjegohet LEKA ËSHTË NË ËNDËRR. Dhe me të vërtetë Leka ishte burrë i madh që mbeti në historinë e botës për të realizuar ëndrrat që ai shihte në gjumë, ky fakt përmendet nga disa shkrimtar dhe historian. Sot shqiptarët emrin Aleksandër e kanë në disa variante si: LEK, ALEKS, SANDRI, LEKSANDËR. Shqiptarët në Itali - arbëreshët dhe në Greqi - arvanitasit në vend të emrit Aleksandër përdornin Leksandër. Duhet të dimë që në kohët e lashta njerëzit shpeshherë e humbnin emrin e pagëzimit dhe thirreshin me Llagapet ose Nofkë. Më vonë Llagapet dhe Nofkat u bënë mbiemrat e familjeve. Janë me qindra shqiptarë që i pagëzojnë fëmijët me emrin Andra. Në Greqi ndodhet një ishull që quhet ANDRA. Gjatë një studimi që kam botuar në vitin 2001 për këtë ishull kam zbuluar se ai banohej që në shekullin e XII nga shqiptarët. Sot ishulli Andra banohet nga 70% e popullsisë greke që flet në familje gjuhën shqipe, pra

[13] Elena Kocaqi, *Albanët me famë në mijëvjeçarë*, Tiranë, 2006, fq.93

nga shqiptarë që njihen me emrin arvanitas. Ishulli ANDRA[14] ka 27 fshatra shqipfolës, toponimet, dhe mbiemrat e familjeve janë të kuptimit të gjuhës shqipe. Emri ALEKSANDËR, pra mund të shpjegohet vetëm në gjuhën shqipe.

Elementët që tregojnë origjinën ilire-shqiptare të Aleksandërit të Madh

1. Më lartë kemi sjellë origjinat familjare të Filipit dhe Olimbisë që vijnë nga fiset ilire. Filipi ishte lindur nga një nënë ilire dhe Olimbia nënën dhe babain e kishte ilir. Shkencërisht ALEKSANDRI I MADH është Ilir, duke pasur parasysh se logjika na shpie se nëna është ajo që përcakton babanë e fëmijës. Pra, Filipi ishte djali i Euridikës që vinte nga fisi ilir i Lynkestëve dhe për Aleksandërin kemi të sigurt që ishte djali i ilires Olimbia, që ishte nga fisi ilir i Epirotëve.

2. Nga pamja e jashtme dhe karakteri Aleksandri i ngjante Olimbisë, kishin të përbashkët ngjyrën e flokëve, bukurinë e fytyrës, ambicien, zgjuarsinë, etj.

3. Emri i pagëzimit të Aleksandërit ishte Meryamun, një emër që zbërthehet në gjuhën shqipe të dialektit gegë, MER-JAM-UN. Sot disa fshatra shqiptar në Maqedoni ende thonë: MER JAM UN, që në gjuhën e njësuar është MIR JAM UNË.

4. Emri i njohur botërisht nga bëmat e Miriamun ishte Aleksandër që siç e shpjeguam më lartë ka kuptim vetëm në gjuhën shqipe.

5. Aleksandri ishte mbajtës i brirëve të Cjapit, shenjë të cilën e kishte mbajtur Pirua, mbreti i Epirit dhe më vonë Skënderbeu, mbreti i Epirit dhe Arbërisë.

[14] Τιτοσ Π. Γιοχαλας, *ΑΝΔΡΟΣ*, Αθηνα, 2000

6. Gjuha që u fliste Aleksandri miqve të tij ishte ilirishtja e dialektit gegë të Maqedonisë. Aleksandri greqishten e mësoi nga Aristoteli.

7. Në vitin 1925, Republika e Shqipërisë nën drejtimin e Ahmet Zogut, monedhën shtetërore e quajti me emrin LEK për nder të Aleksandërit të Madh. Dhe në faqet e monedhës shqiptare LEK pasqyroheshin figurat e Aleksandërit, Herkulit, Akilit, Pirros, etj. Kur shteti shqiptar kishte këto elemente në monedhën e tij në vitin 1925 e deri në vitet 1950, Greqia dhe Republika e Maqedonisë nuk kishin monedhë me këto figura të njohura të historisë së lashtë.

Monedha Lek më pamje të Aleksandrit të Madh, 1926

KAPTINA II

TË DHËNA MBI POPULLSINË E PJESËS EVROPIANE TË PERANDORISË OSMANE

Nëse do ti referohemi shënimeve të regjistrimeve të popullsisë që janë bërë nga fillimi i shek.XIX dhe deri në vitet 1920 do të mësojmë se në këtë periudhë kohore më shumë ka patur banorë shqiptar se sa grek, bullgar dhe serb. Për fat të keq sot shqiptarët për nga numri i popullsisë janë më pak në krahasim me popujt e tjerë si grekët, serbët dhe bullgarët. Siç do vërehet, evropianët, janë më afër realitetit për regjistrimin e banorëve me kombësi shqiptare se sa grekët, bullgarët dhe serbët të cilët siç e kemi thënë më lartë mundoheshin që t'i përfshinin në popullsinë turke myslimane dhe greke ortodokse ose të ulnin sa më shumë numrin e vërtetë të shqiptarëve.

Gjeologu austriak Ami Boues me origjinë franceze (1794-1881), është njeriu i parë i përgatitur për kërkime shkencore në hulumtimin e Gadishullit Ballkanik nga 1836-1838. Veprat e tij të shumta për Turqinë Evropiane tregojnë qartë rrugën e kujdesshme në të cilën ai ka hetuar dhe vendet e vizituara prej tij. Në librin: "LA TURQUIE D'EUROP, observations sur la geographie, la geologie, l'histoire naturelle, etj", jep të dhëna se në pjesën e Perandorisë Osmane të Evropës jetonin 1.600.000 shqiptar, 1.300.000 bullgarë, 1.00.000 grek dhe rreth 1.000.000 serb.[15]

Xavier Heuschling në librin: *"Manuel De Statistuques Ethnographique Universelle",* të botuar në Bruksel më 1847,

[15] Ami Boue, *La Turquie d'Europe; observations sur la geographie, la geologie, l'histoire naturelle, etj.*, Paris, 1840, fq.32

shkruan se në Perandorinë Osmane të Evropës jetonin 1.600.000 shqiptar të krishterë, 1.180.000 grek ortodoks, 900.000 serb dhe 6.000.000 sllavë të krishterë dhe myslimanë (ku janë përfshirë, serbët, bullgarët, boshnjakët, pra popujt sllavë).[16]

Më 1861, Adolphe Joanne dhe Emile Isambert në librin, "Itineraire De L'Orient", shkruajnë që Perandoria Osmane në Evropë kishte 15.000.000 banorë, nga këta 3.000.000 bullgarë, 1.400.000 shqiptar, 1.004.000 serb dhe 975.000 grek.[17]

[16] Xavier Heuschling, *MANUEL DE STATISTIQUES ETHNOGRAPHIQUE UNIVERSELLE*, Bruxelles, 1847, fq.149-150

[17] Adolphe Joanne, Emile Isambert, *ITINERAIRE DE L'ORIENT*, Paris, 1861, fq.313

KAPTINA IV

KAZAJA - PREFEKTURA E KOSTURIT

Qyteti i Kosturit

1.) **KOSTURI** ndodhet në Perëndim të Maqedonisë Gjeografike dhe afër kufirit greko-shqiptar, në jug-lindje të Shqipërisë. Ky qytet shtrihet buzë liqenit me të njëjtin emër në të cilin derdhen lumenj të vegjël nëntokësor dhe mbi tokë. Klima e zonës është me dimër të ashpër dhe verë të freskët. Qyteti në fillim të shek. XXI ka pasur rreth 15.000 banorë.

Sipas të dhënave qyteti është themeluar nga Perandori Justinian dhe në mes të shek. VI, u quajt me emrin Justinianopoli. Por me pushtimin e Ballkanit nga sllavët u ndryshuan edhe shumë emra të qyteteve, fshatrave, maleve, etj., duke u riemëruar me emra sllavë.

Justinianopoli në shek. VIII emërtohet me fjalë sllave, Kostur. Në shek. XI historianët e Bizantit e shënojnë qytetin dhe liqenin me emrin Kastorias. Rreth prejardhjes së emrit Kastorias ka shumë teori. Disa studiues thonë që kjo fjalë lidhet me fjalën latine Castra (kështjellë) që në greqisht pëson përshtatje në Kastro. Një teori tjetër që duket edhe më e kapshme është se fjala Kastorias rrjedh nga fjala greke Kastor duke pasur parasysh se në këtë qytet gjenden punishte të përpunimit të leshit, kastorëve, gunave të ndryshme që shiten nëpër shumë vende të botës.

Kosturi dhe fshatrat e tjera përreth tij për shumë vite kanë qenë sunduar nga shqiptarët, në fillim nga Despot Andrea II, Muzakët. Pas vdekjes së tij këtë qytet e trashëgoi djali i tij

Stojë Muzaka. Në kishën e Shën Athanas Muzakë në Kostur të ndërtuar në shek. XIV janë shënuar emrat e vëllezërve Teodor dhe Stojë Muzaka.

Në kujtimet e Gjon Muzakës thuhet se Muzakajt sundonin qytetin e Kosturit me gjithë fshatrat e tij, të cilin qytet e morën me forcën e armëve prej Karko Kralit. Gjon Muzaka shkruan se Kosturi ose ndryshe edhe Kastorja, është një qytet i bukur me një hyrje të gjerë.[18]

Muzakajve, sipas disa burimeve Kosturin (1383/4) ua kishin lënë për ta qeverisur Ballshajt si vasal të tyre.[19] Ballshajt nëpërmjet lidhjeve të martesave futën nën sundimin e tyre vise nga Lezha, Mati, Kosovën, Dibrën, Ohrin, Kosturin, etj.

Qyteti i Kosturit konsiderohej si pjesë e Shqipërisë (*Castoria in partibus Albaniae)* në shek. IV, këtë e shkruan dhe B. Krekić, në librin e tij, "Dubrovnik (Raguse) et le Levant", Paris 1961. Pra, ishte skaji lindor i asaj, që nga shek. XVI e deri në fillim të shek. XX në një kuptim të gjerë u quajt Shqipëri e Poshtme (Arbëni Poshtërë, Albania Inferior, Bassa Albania, Basse Albanie, Lower Albania).[20]

Në vitin 1385[21] qyteti i Kosturit ra në duart e osmanëve të cilët e zotëruan deri në fund të vitit 1912, kur grekët e morën atë.

Më 1870, Korça u bë Prefekturë e cila kishte nën juridiksionin e saj edhe nënprefekturat e Kosturit, Bilishtit e Kolonjës. Pas luftërave të ndryshme Ballkanike dhe Botërore grekët kryen masakra kundër pakicave më të vogla të cilat ishin të pambrojtura duke djegur e shembur shtëpitë dhe objektet e ndryshme fetare si xhamitë, teqetë, medresetë dhe sinagogat.

---

[18] Gjon Muzaka*, MEMORJE*, Tiranë, 1996, fq.28
[19] Qerim Dalipi*, Studime Albanologjie 3*, Shkup, 2011, fq.24
[20] Pëllumb Xhufi*, Studime Albanologjie 3*, Shkup, 2011, fq.5
[21] Qerim Dalipi, *Inskursionet Osmane në Trevat Shqiptare deri më 1402*, Kërçovë, 2002, fq.72

Deri në vitin 1912, Kazaja e Kosturit ishte nën juridiksionin e Sanxhakut të Korçës (vilajeti i Manastirit). Ky sanxhak ishte i ndarë në 7 Kaza: Kazaja e Korçës, e Starovës, e Bilishtit, e Oparit, e Kolonjës, e Kosturit dhe e Hrupishtit. Këto Kaza ishin të populluara me shumicë nga shqiptarët. Në Sanxhakun e Korçës nuk ka pasur asnjë vendbanim me popullsi greke.[22]

Amin Buen, më 1854 shkruan se Kosturi ka 6.000 - 8.000 njerëz të cilët janë grek, vllahë, turq, evgjitë dhe shqiptarë.[23]

[22] *SHQIP*, Tiranë, 19 Mars, 2011

[23] Ami Boue, *Recueil D'Itineraires Dans La Turquie D'Europ, Detail Geographiques, Topographiques, et Statistiques sur Empire*, Vienne, 1854, fq.275

Ushtarët osman me peshkopin e Kosturit Karavangjeli Germanos. Disa ushtarë nga veshja dallohen se janë shqiptar, 1903

Kartolinë me shënimin, *Kosturi (Shqipëri*

Kartolinë me shënimin, *Kosturi (Shqipëri)*, Medreseja e Kosturit

Kosturi, në qendër dallohet *Xhamia Hasan*, 1916

Mbishkrimi në kishën Shën Athanas Muzaka në Kostur ku janë shënuar emrat e Teodor dhe Stojë Muzaka

Forcat ushtarake Shqiptare në Kostur, Korrik 1908

Peshkatar mysliman në Kostur, 1918

KAPTINA V

KAZAJA - PREFEKTURA E FOLLORINËS

Qyteti i Follorinës

20.) **FOLLORINA** është një qytet kufitar në Greqinë e Veriut dhe i përket Prefekturës me të njëjtin emër. Ai kufizohet me qytetin e Bilishtit të Republikës së Shqipërisë dhe Prespën, në pjesën e Republikës së Maqedonisë. Ky qytet ndodhet në një lartësi 680 metra mbi nivelin detar dhe në regjistrimin e vitit 2011, kishte 22.000 banorë. Qyteti në gjuhën turke quhet - Florina, hebreje - Plurina, shqip - Follorina, bullgarisht dhe sllavo-maqedonisht - Lerin, pra emri i sotëm i qytetit - Florina buron nga turqishtja.

Në kohën e lashtë quhej Lykea dhe i përkiste mbretërisë së nënës së Filipit II, fisit të ilirëve Lynkestë të cilët e shtrinin mbretërinë e tyre përreth liqenit të Ohrit dhe kryeqendrën e kishin në qytetin e sotëm të Manastirit që është afër me Follorinën.

Emile Isambert në vitin 1873, shkruan se Follorina kishte 1.400 familje, të cilët ishin muhamedanë dhe shqiptar otoman, si dhe 100 familje ciganë.[24]

Francezi A. Synvet, profesor i gjeografisë në Liceun e Stambollit, më 1878 shkruan se qyteti i Follorinës kishte 1.800

[24] Emile Isambert, *Οδοιπορικά Μακεδονίας, Ηπείρου και Θεσσαλίας*, Αθήναι, 1878, fq.38

banorë.[25] Ndërsa si qytet Follorina i përkiste, Kazasë së Moglenës, e cila kishte 38.640 banorë.[26]

Në librin, "Ethnographie des Vilayets d'Andrinople, de Monastir et de Salonique", botim i revistës bullgare Extrait du courier d'orinet, botuar në Stamboll më 1878, ku jepen të dhëna vetëm për popullsinë e gjinisë mashkullore thuhet se Follorina ka pasur 1.500 shtëpi ku jetonin 2.800 mysliman (shqiptar, turq, pomak, ciganë, tartarë) dhe 1.800 bullgarë.[27] Ndërsa Kazaja e Follorinës kishte 8.542 shtëpi ku jetonin 5.706 mysliman (shqiptar, turq, tartar, pomak), 16.667 bullgarë, 1.300 vlleh dhe 790 ciganë.[28]

Më 1889, G. T. Verkovik pretendon se Follorina ka pasur 212 shtëpi myslimane dhe 100 të krishtera. Në vitet e luftërave Ballkanike erdhën rreth 300 familje vlleh dhe sllavo-maqedonase nga Magarevo, Nizhepole, Trnovo - Manastiri. Në vitin 1912, popullsia e saj ishte 10 mijë banorë, nga këta 5 mijë mysliman turq, 1.600 romë mysliman, 100 shqiptar mysliman, 50 shqiptar ortodoks, 2.800 sllavo-maqedonas ortodoks, 150 vlleh ortodoks, dhe 300 hebrenj. Deri më 1924 shumica e popullsisë të besimit islam u detyrua të largohet dhe në vend të tyre qeveria greke vendosi 3.600 refugjatë ortodoks vlleh dhe maqedonas nga Manastiri e grek nga Turqia.[29]

Historiani serb Spiridon Gopsheviç, alias Leo Brenner në librin, "Serbia e Vjetër dhe Maqedonia", më 1890, shkruan se në Kazanë e Follorinës jetonin 40.500 serb të krishterë,

[25] A. Synvet, *LES GRECS de L'Empire Ottoman: Etude Statistiques et Ethnographiques, Constantinople*, 1878, fq.51
[26] Po aty, fq.59
[27] *Ethnographie des Vilayets d'Andrinople, de Monastir et de Salonique, Exstrait Du Courrier D'Orient*, Costantinople, 1878, fq.6
[28] Po aty, fq.21
[29] www.lithoksou.net/florina_f.html

Follorina, 1918

Një familje e Bellkamenit

Papa Kristo Negovani, mësonjësi i parë i shkollave shqipe në Prefekturën e Kosturit

Petro Nini Luarasi, drejtori i shkollës shqipe në Negovan



Mesonetoreja Qqip

NEGOVAN.

Negovan, me 10 të Dimrorit 1909.

Në Fort i nderuemi Zoti Kryesuesi i Togerise per arresim Egjp. "Diturija".

Korce

Fort i nderuem Zoti Kryesues!

Si bej të se perpjestemes Heme Egjpuri, de Egjpeto re besnike, me ane te tuej se perunuese s'ani ze fije mar- rume guaim te zeme fije ne Z-ja juaj de me ane te Z-s'Tu aj ne gjithmisat e Togerise, si cilesi me vlejt de ndeer te tquare kryesoni, se me 30 të Brymorit muajit qi dofte hapa me mesonjtore per arresim ne fshatit emadre t'ime Egjpe, de ndodhemi ne voli pe t'u lajmerojme se mesonjtoreja joni je me nejte te sej tregon pemi të mbara, de per sot po nee muron permbi dyzet nxanes djem e cupa, de perdite po ofronene dyke ekspeture nga shoja grekomane, e cila u ndez hapure tre muaj perpara s'emise. Po meqenese kemi mun- gese te mad per libra te cilate nuke pendone ne kyqet te Manastirit de Foforinese, andaj fort nxehete u luta mi te bani perdjejim e te na dergoni ne adresat e u tre-

Letra që pleqësia e fshatit Negovan në fund të vitit 1909, lajmëronte se është hapur shkolla shqipe "Dituria", me mësonjës Petro Nini Luarasi, fq. 1



Fq. 2



Fq. 3

Djemtë e Fisit Bellkameni, nga e majta Spiro Bellkameni, në të djathtë Mihal Bellkameni, foto 1908

KAPTINA VI

TË DHËNA PËR SHQIPTARËT NË PREFEKTURAT E SELANIKUT, EDESËS, VERIAS DHE GREVENAS

Qyteti i Selanikut

43.) **SELANIKU,** është qyteti i dytë më i madh në Greqi për nga numri i banorëve. Ndodhet në rajonin e Maqedonisë Qendrore dhe në këtë qytet funksionon Ministria e Maqedonisë dhe e Trakisë. Sot në Selanik banojnë rreth 1.000.000 njerëz. Pas shpërnguljes së banorëve mysliman pas vitit 1923 në këtë qytet u vendosën mijëra refugjatë të ardhur nga Azia e Vogël. Pothuajse 2/3 e banorëve të këtij qyteti dhe të prefekturës kanë ardhur pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Lozanës.

Që nga viti 1993-2004, kam jetuar në këtë qytet, ku mësova shumë gjëra historike që lidheshin me shqiptarët dhe popujt e tjerë. Gjatë viteve që kalova në Selanik jam takuar me shumë grek me origjinë shqiptare. Në Selanik shumë qytetar grek kanë mbiemra të fjalës shqipe. Rrugës për në spitalin Shën Nikolaos, gjendet një Tavernë, pronari i së cilës quhej Mihal Allvanosi i cili kishte origjinë shqiptare. Në rrugën Politeknou nr. 45 ato vite gjendej zyra e një avokati me emrin Orestis Albanis, po në këtë rrugë kam takuar një avokat në pension që ishte me origjinë shqiptare me mbiemrin Karabina. Në Selanik jetonin edhe nipat e Avni Rustemit, djemtë e motrës, njërin prej të cilëve (Theodhor G) e kam takuar disa herë. Ai, ishte rreth

70 vjeç, më tregoi saktë ku kanë qenë varrezat e shqiptarëve myslimanë.

Selaniku dikur ka qenë qyteti i popujve ballkanik të cilët jetonin së bashku prej shekujsh. Në fillim të shek. XX, jetonin mijëra hebrenj dhe deri në fillim të viteve 1930 ekzistonte varreza më e madhe e tyre me 500.000[30] varre të cilat qeveria greke e atyre viteve i shkatërroi. Hebrenjtë e parë kanë ardhur në Selanik në vitin 140 para Krishtit dhe më 1376 mbërritën hebrenj nga Hungaria dhe Gjermania. Në vitin 1492, 20.000 hebrenj nga Spanja morën leje për tu vendosur në këtë qytet.[31] Gjatë pushtimit gjerman 54.050 hebrenj nga Selaniku u zhdukën në kampet e të burgosurve nga gjermanët.[32]

Sipas regjistrimit zyrtar më 1913, në Selanik u deklaruan 61.439 hebrenj, 45.867 turq, 39.956 grekë, 6.263 bullgarë dhe 4.364 të tjerë, gjithsej 157.889 banorë.[33]

Sot në qytetin e Selanikut jeton, një bashkësi e vogël hebrenj prej rreth 2.000 njerëz dhe kanë një varrezë të vogël në lagjen Evozmos. Shpeshherë varret e hebrenjve dhunohen nga grupe vandalësh.

Turqit pasi e humbën qytetin e Selanikut, një pjesë të madhe u larguan për në Turqi. Sot ndoshta kanë mbetur 2 - 3 mijë veta të cilët merren me punë të rëndomta duke shitur çaj dhe salep nëpër rrugët e qytetit. Ata jetojnë në baraka dhe shtëpi të vjetra duke mos pasur mundësi për ndërtime të reja.

---

[30] Robert D. Kapllan, *GREQIA: Dashnorja e Perëndimit, Gruaja e Lindjes*, Tiranë, 2002, fq.25

[31] Po aty, fq.23

[32] Robert D. Kapllan, *GREQIA: Dashnorja e Perëndimit, Gruaja e Lindjes*, Tiranë, 2002, fq.27

[33] *Τολμων*, Θεσσαλονικη, Ιανουάριος - Φεβρουάριος – Μάρτιος, 2008, fq.62

Shumë pak bullgarë ose sllavo-maqedonas kam takuar në Selanik. Sa kam lexuar në fillim të viteve 1970 qeveria greke zhduki varrezat e tyre dhe ndërtoi pallate mbi to.

Numri i serbëve që kanë jetuar në Selanik nuk dihet, por ata kanë një varrezë të madhe për të cilën tregohet një kujdes i veçantë, me punëtorë dhe roje. Në këtë varrezë mund të hysh vetëm me leje speciale nëse nuk ke kombësi serbe. Ndoshta është varreza më mirë e ruajtur në Greqi, aty janë eshtrat e ushtarëve serb të vrarë gjatë luftërave Ballkanike dhe Luftës së Parë Botërore.

Shqiptarët në fillim të shek. XX kanë zhvilluar aktivitetet politike dhe kulturore në Selanik. Në këtë qytete kanë pasur shtëpi të tyre shumë tregtar nga Korça si dhe ish-kryeministri i Shqipërisë Hasan Bej Prishtina i cili u vra në 1933, po në këtë qytet. Në rrugën Vasilis Ollgas, ku ndodhet ende shtëpia - pallat e Hasan Prishtinës, pak metra më tutje janë dy shtëpi-vila të tregtarëve shqiptar Mehmet dhe Ahmet Kapandzit. (Për familjen Kapandzi, shpeshherë shkruhet se ishin hebrenj mysliman që njihen me emrin Donme, por në disa shkrime thonë se janë shqiptar. Sot familja Kapandzi është e vendosur në Turqi). Këto dy vila u ndërtuan në vitin 1893-1895, në një hapësirë prej 4 hektarësh të cilat shikonin nga deti. Njëra është e modelit zviceran e projektuar nga Piero Arigoni me një dekorim të bukur të tavaneve me piktura. Ndërsa vila tjetër në vitin 1912 u bë rezidenca e princit të Greqisë, Nikollës. Vila Kapandzit më tej u bë rezidenca e kryeministrit të Greqisë, Elefteros Venizellos, ndërsa në vitin 1928 kaloj në pronësi të Bankës Kombëtare Greke. Këto shtëpi gjenden në lagjen e të pasurve ku dikur kishin shtëpitë e tyre turqit, hebrenjtë dhe grekët e pasur.

Në vilën e Mehmet Kapandzi nga Gushti i vitit 1916 e deri nga fundi i vitit 1917 qëndroj Esat Pash Toptani i cili komandonte disa forca ushtarake shqiptare të cilët shërbenin në

mbështetje të ushtrisë franceze gjatë Luftës së Parë Botërore. Esat Pash Toptani mbërriti në Selanik më 27 Gusht 1916 dhe u prit me paradë madhështore nga gjenerali francez Emanuil Serraili. Për shërbimet që i bëri Francës Esat Toptani, do të nderohej nga gjeneral Serrail me Kryqin e Luftës në një ceremoni të madhe të organizuar më 18 Gusht 1917, në qendër të Selanikut.

Sipas gazetës greke *ΜΑΚΕΔΟΝΙΑ,* varrezat e bashkësisë shqiptare që ndodhej në Selanik u prishën në vitin 1983.[34] Në këto varreza ndodheshin varret e shumë personaliteteve të jetës politike dhe shoqërore, por për fat të keq vetëm eshtrat e Hasan Prishtinës shpëtuan dhe u dërguan në Shqipëri pas zhdukjes së kësaj varreze. Deri në vitin 2000, pika gjeografike ku ndodhej varreza shqiptare ishte shënuar gabim në librin e Artë të Selanikut. Gjatë periudhës që jam marrë me studimet historike zbulova faktin që ky vend prej më se 30 vitesh shënohej gabim në hartën e qytetit. Nipërit e Avni Rustemit, djemtë e motrës së tij të cilët ishin shtetas grek dhe deri më 1980 i përkisnin besimit islam, por nga trysnia shtetërore ishin kthyer në ortodoks, me dëshmitë e tyre më treguan se varreza ndodhej në një kodër në lagjen Triandria, ku tani janë ndërtuar pallate. Pasi i dërgova fjalë një këshilltari të Prefektit të Selanikut për këtë gabim u bë edhe korrigjimi i vendndodhjes së vërtetë të varrezave shqiptare në librin e Artë të qytetit. Vendi i varrezave të shqiptarëve ka qenë i blerë nga familjet shqiptare që kanë jetuar dhe punuar në Selanik që në kohën e Perandorisë Osmane.

Në Selanik disa vite ka jetuar Ismail Qemali i cili u martua me një greke me emrin Kleoniki. Gjatë kohës së Kryengritjes së Turqve të rinj (Xhonturqve) në korrik-gusht të vitit 1908, në Selanik kanë qëndruar Çerçiz Topulli, Bajo Topulli dhe Mihal Grameno.

[34] *ΜΑΚΕΔΟΝΙΑ,* Θεσσαλονικη, 27 Tetor, 2007

Në vitin 1916 në qytetin e Selanikut forcat greke të ndihmuar nga ushtria franceze pushkatuan atdhetarin e shquar shqiptar Themistokli Gërmenjin. Për pak muaj qëndroi në këtë qytet edhe mbreti Ahmet Zogu bashkë me shoqëruesit e tij pas largimit nga Shqipëria në 1939.

Me Selanikun lidhet edhe një ngjarje shumë e rëndësishme për grekët dhe Greqinë. Më 26 Tetor 1912, komandanti turk me kombësi shqiptare gjenerali Hasan Tahsin Pasha ia dhuroi grekëve dhe jo bullgarëve qytetin e Selanikut. Hasan Tahsin Pasha pas i dhuroi Selanikun u largua në fillim për në Francë dhe më pas në Zvicër ku vdiq në vitin 1918 në Lozanë të Zvicrës. Aty edhe u varros për herë të parë. Në vitin 1937 Hasan Tahsin Pasha ç'varroset dhe eshtrat e tij u varrosën për herë të dytë në varrezat e shqiptarëve në Selanik, në varrin familjar Mesara. Pasi u prishën varrezat shqiptare më 1983, përsëri ç'varroset dhe rivarroset në varrezat e Malakopit, ku eshtrat i qëndruan 23 vite.[35]

Më 2006 eshtrat e Hasan Tahsin Pashës do të ç'varrosen për të tretën herë për tu rivarrosur me nderime të larta ushtarake bashkë me eshtrat e djalit të tij Qenanit në Muzeun e Luftërave Ballkanike që ndodhet 25 km larg Selanikut në drejtim të qytetit të Edesës. Ndërtesa që është kthyer në Muze ka shërbyer për bisedime midis Gjeneral Mesaresë dhe komandantit të ushtrisë greke Kostandinit nga 25-26 tetori 1912.

Hasan Tahsin Pashë Mesareja kishte 7 fëmijë, prej të cilëve vetëm 3 jetuan, dy djem dhe një vajzë. Njëri nga djemtë e tij ka qenë ambasador i Shqipërisë në Athinë para Luftës së Dytë Botërore. Ai u martua me një greke dhe vdiq në vitin 1968. Vajza e vetme u martua në Turqi. Kurse djali tjetër i Hasan Tahsin Pashës i cili quhej Qenan Mesareja u martua në Janinë me vajzën e shqiptarit Mustafa Pashës që ishte pasanik i madh i Epirit. Qenani kishte mbaruar Institutin francez në

[35] *ΖΩΣΙΜΑΔΕΣ*, Ιωαννινα, Gusht-Shtator-Tetor, 2006, fq.47

Stamboll dhe ishte adjutant i babait të tij. Ai gjithashtu ishte dhe piktor. Shumë piktura të tij gjenden në shtabin e armatës së tretë të ushtrisë, në Janinë, në klubin e oficerëve në Selanik, si dhe në koleksionistët private. Një nga pikturat e rëndësishme është çasti kur babai i tij gjenerali Hasan Tahsin Pasha firmosi dokumentin e dorëzimit të qytetit të Selanikut grekëve në vitin 1912. Qenan Mesareja kishte dy djem, njëri djalë ka jetuar dhe punuar si inxhinier elektrik në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Djali tjetër i Qenanit, Shahini mbas studimeve për arkitekturë në Itali punon dhe jeton në Athinë.[36]

Historia e Hasan Tahsin Mesareja është një nga historitë e shumta të ushtarakëve shqiptar që i kanë shërbyer ushtrive të huaja. Rrugëtimi i Hasan Tahsin Mesaresë nisi në vitin 1845, në fshatin Mesareja në Jugun e Shqipërisë (Mesare ndodhet në rrethin e Kolonjës) dhe përfundoi më 2006 në Veriun e Greqisë, në qytetin e Selanikut.

Dorëzimi i Selanikut nga gjenerali turk me kombësi shqiptare

Pas luftimeve të gjata midis forcave turke dhe forcave të ushtrisë greke në Greqinë e Veriut u arrit armëpushimi. Gjenerali turk me kombësi shqiptare Hasan Tahsin Pasha, në 26 Tetor 1912 kishte firmosur dorëzimin e qytetit grekëve dhe po përgatitej të largohej bashkë me ushtrinë për në Turqi. Më 27 tetor të dërguarit e krye-gjeneralit të ushtrisë bullgare Teodorov, duke mbajtur flamurin e bardhë u takuan me gjeneral Hasan Tahsin. Bullgarët përfaqësoheshin nga një kolonel, dy oficerë dhe kapiteni Standov që më pas u bë ambasador i Bullgarisë në Paris. Gjatë bisedës kapiten Standovi

[36] *GAZETA e Athinës*, Athinë, 13 Shtator, 2002, fq.17

shprehu befasinë dhe pakënaqësinë për dorëzimin e Selanikut grekëve, pasi siç tha ai ushtria bullgare kishte hyrë duke luftuar disa herë në Selanik. Prandaj gëzonte të drejtën që të marrë në dorëzim në emër të naltmadhnisë së tij Carit të Bullgarisë. Por gjeneral Hasan Tahsini u kujtoi bullgarëve që ushtria turke kishte pasur kundërshtar lufte për Selanikun vetëm ushtrinë greke. Koloneli kryetar i përfaqësueses bullgare mbas këtyre fjalëve u përgjigj me tërbim se para pak orëve ushtria bullgare kishte luftuar kundra ushtrisë turke në rrethinat e Selanikut. Prandaj duhej të përgatitej menjëherë një shkresë e posaçme, sipas të cilës qyteti i Selanikut u dorëzohej ushtrisë bullgare. Ndonëse tashmë i mundur, gjenerali Hasan Tahsin Pasha me kryelartësi tha - JO. Atëherë me diplomaci ndërhyri kapiten Standovi për të qetësuar përshtypjen e keqe që kishte lënë koloneli bullgar duke thënë që mbas një përgjigje pozitive për bullgarët Hasan Tahsin Pasha do të vlerësohej nga krye-gjenerali Todorov dhe ushtria e tij. Pas dy orë bisedime pa bindur gjeneral Tahsinin, kapiten Standovi shprehu dëshirë të bisedonte vetëm për vetëm me djalin e gjeneralit, adjutantin Qenan Mesareja. Pasi kaluan në një sallë veçmas zoti Standovi nxori nga çanta e tij një çek të një banke Londineze me një shumë marramendëse, që ia dha adjutant Mesareas duke pëshpëritur se çeku ishte shpërblimi për një firmë të thjeshtë të babait të tij. Në atë çast Qenan Mesareja mbeti i hutuar dhe u kthye në zyrë duke refuzuar shpërblimin. Pasi dështuan kërcënimet dhe shpërblimet e ndryshme, përfaqësuesit bullgarë kërkuan që gjeneral Hasan Tahsin Pasha t'u jepte një kopje të protokollit të dorëzimit të Selanikut forcave të ushtrisë greke. Pasi morën kopjen e protokollit të dorëzimit të qytetit të Selanikut forcave greke, përfaqësuesit e ushtrisë bullgare u larguan për të mos u kthyer më kurrë.

Gjenerali Hasan Tahsin Pashë Mesareja

Varri i Gjenerali Hasan Tahsin Pashë Mesareja në Selanik, 2008

Pritja madhështore që i bëri gjeneral Serraiti mbërritjes së Esat Toptanit në Selanik më 27 Gusht 1916



Esat Pash Toptani në Selanik, 18 Gusht 1917

Vrasja e Hasan Prishtinës në Selanik

Gjatë viteve të jetës në Selanik gjeta një faqe gazete ku përshkruhej vrasja e Hasan Prishtinës në këtë qytet. Gjëja e re që mësova gjatë leximit ishte se Hasan Prishtina ishte vrarë më 13 gusht dhe jo më 14 gusht 1933 siç kemi mësuar nga historianët e ndryshëm që kanë shkruar për figurën e Hasan Prishtinës. Duke lexuar këtë gazetë mësova se vendi ku është qëlluar mbi Hasan Prishtinën ishte vetëm 50 m larg nga vendi im i punës, afër ndërtesës së Mitropolisë së Selanikut.

Gazeta greke "Maqedonia e Re" (Μκεδονικα Νεα) e datës 14 Gusht 1933, një ditë pas vrasjes së Hasan Prishtinës, shkruante për ngjarjen që tronditi Selanikun më 13 Gusht të vitit 1933. Gazeta e asaj kohe shënonte se Hasan Prishtina është pronar i ndërtesës së sotme "Shkolla e të Verbërve".[37] Kjo ndërtesë u ndërtuar me porosi të Hafiz Beut për shtëpi banimi dhe më 1924 e bleu Hasan Prishtina.

Gazeta e kohës përshkruan vdekjen tragjike të atdhetarit, politikanit të madh Hasan Prishtinës. Në faqet e gazetës shkruhej: "Një tjetër vrasje që u bë në rrugën Çimisqi, tronditi Selanikun. Politikani shqiptar Hasan Prishtina u vra në qoshen Çimisqi në Vogaxhiku, përpara bakallhanes "IVI". Shqiptari Ibrahim Çelo, 38 vjeçar, i papunë, qëlloi pesë herë ish-kryeministrin shqiptar Hasan bej Prishtinën.

Vrasja u krye në orën 2 pasdite më datë 13 gusht 1933. Në rrugën Çimisqi u pa një zotëri i moshuar, i mbajtur mirë dhe me tipare simpatike, të ecte përkrah e të fjaloste me një person të veshur mirë, i gjallë, sa e tradhtonte dhe toni i zërit. Arritën në kryqëzimin e rrugës Çimisqi-Vogaxhiku dhe po drejtoheshin

[37] *FAKTI*, Shkup, 20 Gusht, 2005, fq.4

për tek bakallhaneja "IVI" dhe në largësi dy hapa nga kinkaleria e invalidit J. Janopullo. Njeriu me pamje të zymtë nxori rrufeshëm revolverin e markës "SMITH" dhe shtiu kundrejt bashkëbiseduesit, i cili ishte Hasan bej Prishtina, që ra në trotuar. Kalimtarët e mbledhur nga dy të shtënat, panë vrasësin të turret me mizori të pa përshkruar mbi viktimën dhe t'i zbrazë edhe tre plumba të tjerë, dy në kraharor dhe të tretën në kokë, si e shtënë vdekjeprurëse, për të qenë i sigurt për përfundimin e aktit të vrasjes. Fill pas krimit të tij vrasësi, që t'i ikë rrezikut prej turmës së mbledhur që u vu për ta kapur, ia dha vrapit nga rruga Vogaxhiku. Nga tronditja ai ra në vitrinën e tregtores "Beharnae" të cilës ia dëmtoi tendën, por rimori veten, për t'u turrur drejt rrugës "Paleon Patron" ku u rrethua nga turma, që e ndiqte me synime të errëta. Vrasësi hyri në banesën e mjekut z. Dukidhis, ku dhe iu dorëzua rojës së policisë. Por nuk mundi t'i shpëtojë egërsimit të turmës. Kalimtarët që e ndoqën dhe banuesit fqinjë të çdo moshe, shtrese, pa ditur identitetin e tij dhe as motivet e vrasjes, të indinjuar ndaj egërsisë që tregoi vrasësi ndaj viktimës, sa panë të vijë skuadra e policisë, u turrën dhe ata duke thirrur: - Shqyeni, shqyeni, vrasësin. Ndërsa polici më kot përpiqej të shpëtonte atentatorin, turmat u turrën ndaj tij dhe nisën ta grushtojnë, duke i shkaktuar mavijosje në pjesë të ndryshme të trupit. Do ta kishin çarë përgjysmë vërtetë, nëse nuk do ia mbërrinte të hynte në një tjetër shtëpi, në rrugën "Paleon Patron", ku u strehua nga i zoti i shtëpisë, i cili nxitoi tu mbyllte derën e jashtme turmave të zemëruara. Pas pak mbërriti sekretari i policisë, kapiteni z. Zografo, dhe vrasësin e transferuan me motoçikletë në Seksionin e tretë të policisë. Hasan Prishtina, i mposhtur nga plagët, u dërgua ndërkohë në Spitalin Popullor, ku trupit të tij iu bë autopsia. Në orën 2.50 minuta pasdite oficeri Sotiriu nisi hetimet me përkthyes, pyeti

vrasësin nëse e njeh gjuhën greke. Ai u përgjigj se njeh gjuhën shqipe, frënge dhe gjuhën turke.

Vrasësi nënvizoi se akti i tij u dedikohet motiveve politike. Ndërkaq pretendoi se ish-kryeministri i atdheut të tij ishte komit dhe bashkëpunonte me komitetin bullgar-maqedonas me qëllim që të vrisnin mbretin e Shqipërisë Ahmet Zogun. Planet, thotë atentatori, m'i tregoi Hasan Prishtina përpara pesëmbëdhjetë ditëve, kur po vinim prej Vjene (Austri) dhe më bënte presion që të bëhesha unë kryetar i bandës komit dhe të shkoja në Tiranë e të vrisja mbretin Ahmet Zogu. Prishtina, vijon vrasësi, më premtoi shpërblim mujor dhe një shpërblim dhuratë pas aktit të vrasjes, por unë i kundërshtova këto propozime të tij, sepse jam pro regjimit te mbretit Ahmet Zogu dhe nuk dëshiroja të bëhem vegël e Hasan Prishtinës, të cilin në Shqipëri e quajnë tradhtar. Ibrahim Çelo jetonte në Nikea të Francës dhe ishte tregtar frutash, ishte i martuar me një spanjolle, me të cilën kishte dhe fëmijë. Atje u njoh përpara disa vitesh me Hasan Prishtinën, që ishte shpërngulur në Nikea për hir të çlodhjes dhe kishin lidhur marrëdhënie familjare. Gjatë njohjes midis tyre Hasan Prishtina i kishte treguar për rininë, vështirësitë që kishte kaluar pas largimit nga Shqipëria në Turqi dhe Bullgari. Në Turqi pat gjetur miq të vjetër dhe bashkëluftëtarë kundër xhonturqve. Mori pjesë në një shoqatë të fshehtë me bashkatdhetarët e vet për çështjen shqiptare".

Shtëpiae Hasan Prishtinës në Selanik, foto 2008

Μία άλλη δολοφονία που έγινε στην οδό Τσιμισκή συγκλόνισε τη Θεσσαλονίκη. Ο Αλβανός πολιτικός Χασάν Μπέης Πρίστινα δολοφονήθηκε στη γωνία Τσιμισκή και Βογατσικού από πολιτικό του αντίπαλο, το 1933. Η δολοφονία έγινε με περίστροφο, μπροστά στο εδωδιμοπωλείο "Ήβη". Η *εικόνα 180* είναι από τα *Μακεδονικά Νέα* (14.8.1933). Ο Χασάν ήταν ιδιοκτήτης της σημερινής "Σχολής Τυφλών".

Η ΧΘΕΣΙΝΗ ΠΟΛΙΤΙΚΗ ΔΟΛΟΦΟΝΙΑ

ΕΝΑΣ ΑΛΒΑΝΟΣ ΕΦΟΝΕΥΣΕ ΤΟΝ ΧΑΣΑΝ ΒΕΗΝ ΠΡΙΣΤΙΝΑΝ ΑΦΟΥ ΕΠΥΡΟΒΟΛΗΣΕ ΠΕΝΤΑΚΙΣ ΕΝΑΝΤΙΟΝ ΤΟΥ ΘΥΜΑΤΟΣ ΤΟΥ ΤΟΥ ΕΡΡΙΨΕ ΚΑΙ ΤΗΝ ΧΑΡΙΣΤΙΚΗΝ ΒΟΛΗΝ ΕΙΣ ΤΟΝ ΚΡΟΤΑΦΟΝ ΤΙ ΛΕΓΕΙ Ο ΔΟΛΟΦΟΝΟΣ ΚΑΙ ΠΟΙΟΝ ΗΤΟ ΤΟ ΑΤΥΧΕΣ ΘΥΜΑ

ΠΩΣ ΕΓΙΝΕΝ Η ΔΟΛΟΦΟΝΙΑ

Ο Δολοφόνος Ύμπραήμ Σέλιο

Ο δολοφονηθείς Χασάν βέης Πριστίνα

ΟΙ ΛΟΓΟΙ ΤΗΣ ΔΟΛΟΦΟΝΙΑΣ

ΤΑ ΠΡΟΗΓΗΘΕΝΤΑ ΓΕΓΟΝΟΤΑ

Η ΚΑΤΑΔΙΩΞΙΣ ΤΟΥ ΔΡΑΣΤΟΥ

Gazeta greke ku shkruhet për vrasjen dhe shtëpinë e Hasan Prishtinës në Selanik

Të dhëna për Selanikun dhe fshatrat ku banojnë shqiptarët

Pra, me qytetin e Selanikut lidhen dy ngjarje historike për shqiptarët në fillim të shek. XX edhe pse në këtë qytet kanë jetuar një numër i vogël i shqiptarëve në krahasim me turqit, hebrenjtë, bullgarët dhe grekët.

Revista greke *PANDORA*, e Qershorit të vitit 1869 shkruan se në prefekturën e Selanikut banonin 318.000 grekë, 19.000 shqiptarë, 15.000 vllahë, 17.000 sllavë, 12.000 ciganë dhe 26.000 hebrenj.[38]

Historiani serb Spiridon Gopsheviç alias Leo Brenner në librin "Serbia e Vjetër dhe Maqedonia", më 1890, shkruan se në Kazanë e Selanikut jetonin: 67.000 serb të krishterë, 2.800 serb mysliman, 42.000 turq, 450 shqiptarë, 24.000 grekë, 1.250 vllahë, 5.000 hebrenj mysliman, 55.000 hebrenj dhe 3.500 të tjerë.[39]

Në vitin 1900 Vasili Kënçov shkruan se Selaniku kishte, 10.000 bullgarë të krishterë, 26.000 turq mysliman, 16.000 grekë të krishterë, 55.000 hebrenj, 2.500 ciganë dhe 8.500 të tjerë.[40]

Brankofi në librin e tij për regjistrimin e popullsisë së krishterë për Maqedoninë sjell të dhëna për Selanikun se

[38] *ΠΑΝΔΩΡΑ*, Athinë, 15 Qershor, 1869, fq.110
[39] Спиридона Гопчевића, *Стара Србија и Македонија,* Београд, 1890
[40] Васил Кънчов, *Македония етногрфия и статистика*, София, 1900, fq.440

banojnë 8.000 bullgarë të krishterë, 20.000 grek, 900 vlleh, 90 shqiptarë dhe 60 ciganë.[41]

[41] D. M. Brancoff, *La Macédoine et sa population chrétienne*, Paris, 1905, fq.218

Shtëpia e tregtarit shqiptar Mehmet Kapandzit, ndërtuar më 1893, foto 2008

Vila e Ahmet Kapandzi, ku qëndroj 1916-1917 Esat Pash Toptani, foto 2012

Myslimanët duke u larguar nga Selaniku

Të dhëna për shqiptarët në qytetin e Edesës

47.) **EDESSA**, është një qytet rreth 150 km nga kufiri me Shqipërinë. Këtë qytet, i cili pamjen e brendshme e ka si të qytetit të Follorinës e kam vizituar disa herë. Në vitin 1886 Nikolaos Shina shkruan se në të kishte, 7.000 të krishterë dhe 2.000 myslimanë.[42] Ndërsa bullgari Jordani Ivanov jep të dhëna se në këtë Kaza banonin, 15.000 bullgarë, 7.200 turq, 1.350 vllehë, 20 shqiptarë dhe 800 ciganë.[43] Pak vite më vonë serbi Borivoje Millojeviç shkruan se në të ka pasur 1.550 shtëpi ku banonin sllav të krishterë dhe 200 shtëpi sllav myslimanë, 12 shtëpi shqiptarë mysliman, 700 turq mysliman, 200 shtëpi vlleh dhe 53 shtëpi ku banonin grek.[44]

[42] Νικόλαυ Θ. Σχινά, *Οδοιπορικαί σημειώσεις Μακεδονίας, Ηπείρου, Νέας οροθετικής γραμμής και Θεσσαλίας,* Αθήναι, τόμοι Α, 1886. fq.164
[43] Йорданъ Ивановъ, *Българите в Македония. Издирвания и документи за тяхното потекло, език и народност с етнографска карта и статистика*, София, 1915, fq.CII
[44] Боривоје Милојевић, *Јужна Македонја - Антропогеографска*, Београд, 1920, fq.27

Të dhëna për shqiptarët në qytetin e Verias

48.) **VERIA**, sipas Jordani Ivanov, më 1915 në Kazanë të Verias jetonin 7.250 bullgarë, 6.280 turq, 15.00 grekë, 8.500 vllehë, 500 shqiptarë, 1.900 ciganë dhe 850 hebrenj.[45]

Diplomati Halkopulos shkruan se qyteti i Verias kishte 6.200 grek, 5.280 myslimanë dhe 600 hebrenj.[46]

Të dhëna për shqiptarët në Prefekturën e Grevenas

49.) **TRIVENI** që njihej dhe si Trivia, Trivesht, Tevren, në vitin 1927 u quajt Sindhendhron. Ky fshat ndodhet 10 km larg qytetit të Grevenas dhe e kap Maqedonia Perëndimore. Bullgari Vasili Kënçov shkruan se në të kanë banuar 120 grek të krishterë dhe 150 shqiptarë mysliman.[47] Halkopulos më 1910 thotë se Triveni kishte 156 grek dhe 245 mysliman.[48] Pas Marrëveshjes së Lozanës më 1923, familjet shqiptare myslimane u shpërngulën për në Turqi dhe në vend të tyre u vendosën refugjatë nga Azia e Vogël. Sot ka rreth 200 banorë.

[45] Йорданъ Ивановъ, *Българите в Македония. Издирвания и документи за тяхното потекло, език и народност с етнографска карта и статистика*, София, 1915, fq.CII
[46] Αθανάσιος Χαλκιόπουλος, *ΜΑΚΕΔΟΝΙΑ – ΒΙΛΑΕΤΙΑ, ΤΗΕΣΣΑΛΟΝΙΚΗΣ-ΜΩΝΑΣΤΙΡΙΟΥ,* (*Εθνολογική στατιστική των βιλαετίων Θεσσαλονίκης και Μοναστηρίου*), Αθήναι, 1910, fq.18
[47] Васил Кънчов, *Македония етногрфия и статистика*, София, 1900, fq.576
[48] Αθανάσιος Χαλκιόπουλος, *ΜΑΚΕΔΟΝΙΑ – ΒΙΛΑΕΤΙΑ, ΤΗΕΣΣΑΛΟΝΙΚΗΣ-ΜΩΝΑΣΤΙΡΙΟΥ,* (*Εθνολογική στατιστική των βιλαετίων Θεσσαλονίκης και Μοναστηρίου*), Αθήναι, 1910, fq.113

KAPTINA VII

FSHATRAT SHQIPTAR NË PREFEKTURAT E EVROS, RODHOPIT DHE KSANTHIT

Gjatë Luftërave Ballkanike (1912-1913) shumë shqiptarë ortodoks të cilët jetonin në Trakinë Lindore të Turqisë si në fshatrat Megalo Zaloufi, Ambalar, Sulltankio u masakruan dhe u plaçkitën nga ushtria turke. Të ndodhur midis dy zjarreve, atij turk dhe grek, të gjendur në rrugë si jetimë, shqiptarët e Trakisë Lindore zgjodhën rrugën për të qenë qytetar të shtetit grek. Pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Lozanës, ata i braktisën fshatrat e tyre duke u shpërngulur në Greqi si popullsi e shkëmbyeshme. Shumë shqiptarë mysliman u shkëmbyen si turq me shqiptarë ortodoks të cilët u shkëmbyen si grek. Ky ishte fati i zi i mijëra shqiptarëve mysliman në Greqi dhe shqiptarëve ortodoks në Turqi.

Më 1868, Thimi Mitko, i bën letër De Radës dhe thotë se në jug të Edrenesë janë disa fshatra shqiptare. Po këtë informacion ia jep edhe Dhimitër Kamardës. Më 1895, Sami Frashëri, do të shkruante për ekzistencën e këtyre fshatrave shqiptare.[49]

Në vitin 1910, Hysni Ahmet Frashëri në: "*Kalendarin Kombëtar*" që botohej në Sofje, shkruan se në Adrianopojë (Edrene), gjenden tetë fshatra shqiptarë, që flasin gjuhën e vetë. Ato fshatra janë: Mandrica me 650 shtëpi (ndodhet në Bullgari, shënim A. LL), Kaza Ortaqoj, Ibriktepe me 400 shtëpi, Kaza Uzunqopri Alltantash me 150 shtëpi, Pazardere me 150 shtëpi,

[49] *SHQIP*, 22 Qershor, 2007, fq.18

Kaza Abellar me 100 shtëpi dhe Kaza Kërxhalli me 80 shtëpi. Mandrica, Ibriktepeja dhe Zallofi janë mydarije. Nga Zallofi 14 vjet më parë, u ndanë 60 shtëpi dhe blenë fshatin Abellar. Përsëri nga ky fshat u ndanë 9 vjet më parë 16 shtëpi dhe blenë fshatin Kërxhali. Së bashku këto fshatra kanë afro 20.800 banorë. Përveç shqipes nuk flitet tjetër gjuhë. Tani, nja dhjetë vjet më parë kanë hapur edhe shkolla greqisht.[50]

Shqiptarët ortodoks që pas vitit 1921 u shpëngulën nga fshatrat e tyre në Trakinë Lindore që është pjesë e Turqisë, u vendosën në Evron e Veriut, në Serres dhe në Selanik. Ata u vendosën në fshatrat Dikaia, Kavili, Sakko, Kliso, Neo Himonio, Thurio, Sofiko, Asimenio, Rigio, Pitho të Evros së Veriut, ndërsa në Serres qëndruan në Neohorio, Paralimnio, Nea Petra, Tholo dhe Komisi.

Sipas studiuesit Antonio Bellushi janë 26 fshatra në zonën e Thraqi - Evros si: Altintas, Erasmjo, Imbrik Tepe - Qiuteza, Jemisti, Mandrica, Megalo Zaloufi, Mavroklisi, Kavilli - Evros, Sakos - Evros, Nea Bisha - Evros, Marasja - Evros, Neon Hieimonion-Evros, Ferresi - Aleksandropolis, Poros-Aleksandrupolis, Ifestos - Komotinis, Ipsante - Komotinis, Mega Kranovunion - Komotinis, Mesohorjon - Komotinis, Mikro Kranovunion - Komotinisë, Kipseli - Ksanthis, Mellisa - Ksanthis, Paradhimi - Sufllion, Pepllos - Sufllion, Qipi - Sufllion, Tihjeron - Sufllion dhe Sulltan – Kioi, Tihjeron-Sufllion.[51]

Në një shkrim të gazetës *SHQIP*, thuhet se janë 14 fshatra përreth lumit Evros në Greqi që i kanë bërë shqiptarët bashkë me grekët. Më shumë se 30 mijë shqiptarë banojnë në Feresi, Tiqero, Poro, Ardhanio, etj. Kanë lënë Qytezën dhe

[50] Alush Kamberi,Muharrem Idrizi, *4 Shekuj të pa Gjunjëzuar Shqiptarët e Mandricës*, Tetovë, 1997, fq.12

[51] Antonio Bellusci, *RICERCHE E STUDI TRA GLI ARBERORI DELL' ELLADE*, Cosenza, 1994, fq.42

Qafëzezin e Kolonjës në shekullin e 17 dhe për dyqind vjet kanë jetuar në Turqi. Në 1920, i përzunë nga Edreneja turke, si grekë ortodoksë. Shqiptarët kaptuan një lumë dhe ndërtuan një jetë, ca hapa tej kufirit, në Greqi. Në Ibrik Tepe, Alltentash, Sulltanqoi kanë lënë shtëpitë dhe varret. Këtu kanë fëmijët, arat dhe njëri-tjetrin. Humbën dhe harruan shumë në rrugën e gjatë Kolonjë-Ederne-Aleksandropul, veç gjuhën dhe gjakun jo.[52]

Për shqiptarët që u vendosën në Evros, prof. Nasho Jorgaqi thotë se: "Shqiptarët e këtyre 7-8 fshatrave të Arnautqoit u vendosen si fillim në krahinën e Aleksandropulos dhe në këtë zonë ata u vendosën në fshatrat greke e nuk krijuan fshatra shqiptare, por sipas të dhënave që kemi, ata në fshatrat greke zënë 5 deri në 90%, duke u vendosur në Feres, Qipi, Pepel, Ardhanjo, Poros, Apollo, ndërsa të tjerët u vendosen në zona të tjera të fshatrave të Greqisë si Qimono, Sako, Kavili, Portokalis, etj".[53]

Sipas historianit Evagjelos Avdhikos shqiptarët e Trakisë Lindore u vendosën kryesisht në Evron Veriore si në fshatrat Dikaia, Kavili, Sakko, Kleiso, Neo Heimonio, Thourio, Sofiko, Asimenio, Rigio dhe Pithio. Në Maqedoninë (greke), në prefekturën e Serresit u vendosën në këto fshatra: Neo Horio, Paralimnio, Nea Petra, Tholo, Koimisi dhe në fshatin Kalohori të Selanikut.

Në luftën e dytë Ballkanike fshati Mandrica ku banonin dhe banojnë sot e kësaj dite shqiptarë, i kaloj Bullgarisë. Sipas të dhënave të vitit 1913, Mandrica ka patur 2.050 banorë, por shumë familje shqiptare për ti shpëtuar masakrave bullgare u shpërngulën më 1926 nga Mandrica tashmë e Bullgarisë në fshatrat e Greqisë si në: Suroti (20 familje), Triadhi (9 familje), Selanik, Mostheni (50 familje) - Kavalla, Mandres (200 familje) - Kilkis, Protoklisi (60 familje), Maroklisi (40 familje),

[52] *SHQIP*, 22 Qershor, 2007, fq.18
[53] Po aty

Thurio (10 familje) - Evro dhe në Kalo Agro (20 familje) - Dhrama.

Banorët e Sulltankoi dhe të Ibrik-Tepe u vendosën në fshatrat Bintikli (Tiqero), Hanxhias (Tarsio), Çakirxhi (Pirolithos), Ferexhik (Feres), Marhanli (Peplos), Gjemexhiki (Gjemisti), Bazi-Bei (Kipo), kurse shqiptarët që banonin në fshatin Altin-Tas u vendosën në Paradhimi Rodopis, Sarhanli (Ardhanio) të Evros. Shqiptarët e Gjilanli dhe të Karaxha Halin u vendosën në Antheia të Evros. [54]

Në vitin 1873, Sulltankoi kishte 2.000 banorë, ndërsa Ibrik-Tepe në vitin1905 kishte 2.320 banorë. Më 25 nëntor 1881, fshati Altin-Tas kishte 1.200 banorë.[55]

Mandrica e Bullgarisë, pas luftërave ballkanike ka pasur 400 shtëpi me shqiptarë. Ndërkohë nga Mandrica në Greqi u shpërngulën shumë shqiptarë, dhe themeluan fshatin e tyre me emrin Mandres. Kjo ngjau me një marrëveshje midis shtetit bullgar dhe atij grek pas Luftës së Parë Botërore.[56]

Shumë studiues shkruajnë se shqiptarët që jetojnë në Trakinë greke janë rreth 40.000 banorë. Studiuesit si Aristidh Kola, Kosta Kazaqi dhe Evangjelos Gr. Avdhikos shkruajnë se këta allvanos kanë ardhur në Traki të ftuar nga Sulltan Selimi, kur ai donte të ndërtojë një xhami më të madhe se ajo e Mekës e cila kishte 1000 dritare.[57] Ato vite Vezir i Sulltanit ishte shqiptari Mehmet Sokoli[58] që ia besoi arkitekturën shqiptarit tjetër Sinanit, i cili për ndërtimin e xhamisë angazhoi mjeshtërit shqiptarë nga Kolonja, Korça Devolli, etj. Xhamia u ndërtua në

[54] Δημιτρης Χρ. Δαλατσης, *Οι Αρβανιτες της Ανατολικης Θρακης*, Athinë, 2012, fq.24-25
[55] *ΜΠΕΣΑ*, Athinë, Janar-Shkurt, 1993, fq.8-9
[56] Alush Kamberi,Muharrem Idrizi, *4 Shekuj të pa Gjunjëzuar Shqiptarët e Mandricës*, Tetovë, 1997, fq.10
[57] *ΜΠΕΣΑ*, Athinë, Janar-Shkurt, 1993, fq.6
[58] Po aty, fq.7

Edrene me 999 dritare. Sulltani i mahnitur nga bukuria e saj pyeti Vezirin se çfarë dëshire kanë ndërtuesit. Mjeshtërit kërkuan që të mbeteshin me familjet e tyre në Traki. Por i këtij mendimi nuk është Fan Noli i cili shkruan se shqiptarët në Traki njihen që nga koha e Bizantit dhe se kishin mbetur aty bashkë me familjet e tyre. (Për shqiptarët e Trakisë, kanë shkruar Thimi Mitko, De Rada dhe Sami Frashëri).

Si do që të jetë e vërteta për ardhjen e shqiptarëve në zonën e Trakisë-Evros, ne kemi të bëjmë me një fakt të vërtetë historik që sot kjo zonë banohet nga grekë me origjinë shqiptare që ende flasin gjuhën shqipe dhe kërkojnë që gjuha e të parëve të tyre të mos humbasë, të mos jetë një atdhe i humbur. Ata, disa herë janë shprehur nëpërmjet shtypit dhe televizioneve shqiptare për kujdesin që duhet të tregojë shteti grek të cilit i përkasin sot, por edhe nga shteti mëmë Shqipëri, për hapjen e shkollave në gjuhën amtare shqipe në komunën e Tiqeros, ngjashëm me të drejtat e shkollimit që minoriteti grek dhe minoritetet tjera i gëzojnë në Shqipëri.

Kur u vendosën në fshatrat e rinj në tokën greke pas vitit 1922, allvanosët apo arvanitasit siç i quajnë shqiptarët që u shpërngulën nga Turqia për në Greqi, nuk kishin marrëdhënie të mira me fshatrat fqinjë që banoheshin nga grekët. Ata, nuk merrnin dhe as jepnin nuse për njeri-tjetrin. Të moshuarit kujtojnë që kur thirreshin në shkollë nga mësuesit për ecurinë e fëmijëve të tyre prindërit këshilloheshin që mos të flisnin përpara fëmijëve në gjuhën shqipe, por të bisedonin vetëm greqisht. Sipas mësuesve grek, kjo bëhej për të mirën dhe të ardhmen e fëmijëve të tyre që vinin nga familjet shqiptare. Shpeshherë fëmijët shqiptar ziheshin me grushte dru me fëmijët grekë, kur këta të fundit e quanin gjuhën shqipe gjuhë evgjiti apo gjuhë turke.

Disa të dhëna rreth problemeve midis allvanosëve dhe grekëve nga fshatrat fqinjë, na sjell historiani Evagjelos Gr.

Avdhikos, i cili në vitin 1998 ka botuar një libër me titull "Απο τη Μαριτσα στον 'Εβρο"(Nga Marica në Evro). Ai na sjell të dhëna historike dhe kulturore mbi popullsinë Allvanose, të cilët i quan arvanitas dhe banojnë në fshatin Tiqero, edhe mbi popullsinë greke që banon në fshatin Filaktu. Tiqeroja banohet 90% nga allvanosët e ardhur nga Ibrik-Tepe dhe Sulltankoi, por ka edhe një pakicë popullsi greke. Ndërsa Filaktu banohet nga grekë të ardhur nga Turqia ose Trakia Lindore. Këto dy fshatra në vitin 1986, kanë themeluar Komunën e Tiqeros.

Arvanitasit, pra shqiptarët që janë banorë të Lashtë të Greqisë kanë lidhje të ngushta jo vetëm me allvanosët (shqiptarët) e Trakis-Evros, por me të gjithë allvanosët nga Follorina e deri në Janinë. Ata së bashku më 1983 kanë themeluar Lidhjen e Arvanitasve të Greqisë, dhe në fillimet e viteve 1980 botonin edhe revistën BESA. Këta arvanitas dhe allvanos pavarësisht se si grekët i thërrasin apo i emërtojnë nëpër librat e tyre të historisë, kanë të përbashkët gjakun, gjuhën, kulturën, i përkasin një fisi që sot njihet me emrin shqiptar. Kanë ruajtur në kujtesën e tyre dashurinë për historinë e tyre, krenohen me trimëritë e Skënderbeut. Prandaj duhet të kujdesemi dhe të regjistrojmë të dhënat e tyre historike e kulturore sepse janë vlera të ruajtura me fanatizëm në kushte e të shtypjes së politikës keqdashëse shtetërore greke.

Duke jetuar për disa vite në Greqi dhe duke u marrë më çështjen e shqiptarëve të Greqisë pata rastin të njoh shqiptarët e Trakis-Evros, të miqësohem dhe me disa prej tyre në Shtator të vitit 2004, të vizitojmë Kosovën.

Nga studimet që kam bërë prej kaq vitesh, kam nxjerrë të dhëna se në Trakinë greke, shqiptarët i gjejmë në rreth 30 fshatra. Për fat të keq qeveritë shqiptare ndër vite asnjëherë nuk treguan përkujdesje për këto fshatra. Tirana zyrtare, shqiptarëve të Trakisë asnjëherë nuk ua mundësoi që në mënyrë të organizuar të vizitojnë Shqipërinë, dheun e të parëve të tyre.

Sido që të jetë këta shqiptar që herë-herë grekët i thërrasin allvanos ose arvanitas u kanë mbijetuar presioneve të ndryshme shtetërore në shtetin ku jetojnë duke ruajtur në mendjen e tyre origjinën e tyre. Greqia me të gjitha format është munduar t'i asimilojë ata, duke i shpërndarë në zona dhe qytete të ndryshme larg njeri-tjetrit, duke i ndarë familjet në disa pjesë për të humbur lidhjet midis tyre, por këta shqiptar edhe në kushte të një shtypjeje shtetërore arritën të mbijetojnë bashkë me gjuhën dhe zakonet e tyre të lashta shqiptare.

Fshatrat shqiptare të Prefekturës së Evros

Prefektura e Evros gjendet në verilindje të Greqisë, dhe kufizohet me Bullgarinë dhe Turqinë. Në këtë prefekturë kalojnë shumë lumenj. Midis tyre edhe lumi Evro i cili është 530 km i gjatë dhe buron nga malet e Bullgarisë. Lumi Evro është pikë e përcaktimit kufitar me Turqinë dhe Bullgarinë. Prefektura e Evros ka si kryeqendër qytetin e Aleksandropolit i cili është 840 km larg Athinës, 340 nga Selaniku dhe 295 nga Stambolli (Kostandinopoja). Kjo prefekturë ka 13 Komuna si Aleksandropolis, Bissas, Didimoteikos, Kiprinou, Metaksadon, Orestiada, Orfea, Samothraqi, Sofliu, Traianopolis, Trigonu, Tiheros dhe Feron. Në bashkinë e Aleksandropolis banojnë rreth 150.000 njerëz.

KAPTINA VIII

FSHATRAT SHQIPTAR NË PREFEKTURAT E KAVALLËS, DHRAMËS, SERRESIT DHE KILKISIT

Fshatrat shqiptarë të Prefekturës së Kavallës

Prefektura e Kavallës ndodhet në pjesën Lindore të Maqedonisë dhe kufizohet me prefekturën e Serresit, Ksanthit dhe Dhramës. Sot ka rreth 145.000 banorë të cilët jetojnë në 11 komuna. Para se të vinin refugjatët në Kavallë nga Trakia Lindore, Azia e Vogël dhe Rusia pas vitit 1920, banon rreth 23.000 njerëz, ortodoks, mysliman dhe hebrenj. Me nënshkrimin e Marrëveshjes së Lozanës për shkëmbimin e popullsisë 10.000 mysliman e braktisën qytetin duke u larguar për në Turqi, në vend të tyre u vendosën rreth 30.000 refugjatët të cilët tashmë do të ishin shumicë në krahasim me vendasin e mbetur. Deri në vitin 1946, qyteti i Kavallës i përkiste prefekturës së Dhramës. Në vitin 1769 në Kavallë ka lindur Mehmet Ibrahim Aliu, themeluesi i mbretërisë së Egjiptit i cili ishte shqiptar.



Kavalla 1917

Tregu në Kavallë, 1920

Fshatrat shqiptarë të Prefekturës së Dhramës

Prefektura e Dhramës i përket rajonit të Maqedonisë Lindore dhe Trakisë. Sot në këtë prefekturë jetojnë rreth 104.000 njerëz në 9 komuna.

Fshatrat shqiptarë të Prefekturës së Serresit

Prefektura e Serresit i takon rajonit të Maqedonisë Qendrore. Ajo kufizohet në lindje me Dhramën dhe Kavallën, ndërsa në perëndim me qytetin e Selanikut dhe të Kilkisit. Është prefekturë kufitare e cila kufizohet me Bullgarinë dhe me Maqedoninë.

Në prefekturën e Serresit jetojnë rreth 176.430 banorë, prej tyre 76.817 jetojnë në qytetin e Serresit. Në këtë prefekturë ka disa fshatra të banuar me shqiptarë të shpërngulur nga Trakia Lindore e Turqisë, por edhe shqiptarë të cilët kanë jetuar aty para vitit 1922.

Fshatrat shqiptarë të Prefekturës së Kilkisit

Prefektura e Kilkisit ndodhet në Maqedoninë Qendrore greke dhe kufizohet me Republikën e IJR Maqedonisë dhe me prefekturën e Selanikut. Në këtë prefekturë sot banojnë rreth 80.000 njerëz me kryeqendër qytetin e Kilkis. Ky qytet karakterizohet me dimër të ashpër dhe verë të nxehtë.

Myslimanët largohen nga Greqia për në Turqi pas vitit 1922

Myslimanët largohen nga Greqia për në Turqi pas vitit 1922

Myslimanët largohen nga Greqia për në Turqi pas viti 1922



Refugjatët e ardhur nga Azia e Vogël duke pritur në Evros se në cilat zona do ti caktojë qeveria greke për tu vendosur, 1923

Refugjatët e ardhur me tren nga Azia e Vogël, 1923

Refugjatët e ardhur nga Azia e Vogël, 1923

Refugjatët nga Azia e Vogël të ardhur në Greqi, 1923

TABELAT E TË DHËNAVE

Vendbanimet ku është folur gjuha shqipe deri ne vitin 1913

	Emrat e vjetër	**Emrat e sotëm**	**Prefekt-urat**
1	KOSTURI	Kastoria (Καστορια)	Kastoria
2	VIÇISTA	Niki (Νικη)	
3	KOTELCI	Kotili (Κοτυλι)	
4	MIROSLLAVICA	Milovlitis (Μυλοβλιτης)	
5	SEMASI	Kremaston (Κρεμαστον)	
6	SLIVENI	Koromila (Κορομηλια)	
7			
8			
9			
10			
11			
12			
13			
14			
15			
16			
17			
18			
19			
20			
21			
22			
23			Florina
24			
25			
26			

27			
28			
29			
30			
31			
32			
33			
34			
35			
36			
37			
38			
39			
40			
41			
42			
43			
44			
45			
46			
47			
48			
49			
50			
51			
52			
53			
54			
55			
56			
57			Ksanthi
58	SHAHIN	Ehinos (Εχινος)	
59	ILICA ORTA MAHALLA	Thermes (Θερμες)	

Fshatrat ku u vendosën shqiptarët pas vitit 1922 të ardhur nga Trakia Lindore e Turqisë

	Emrat e sotëm të fshatrave	**Prefekturat**
1		Selanik -(θεσσαλονικης)
2		
3		
4		Evros – (Εβρου)
5		
6		
7		
8		
9		
10		
11		
12		
13		
14		
15		
16		
17		
18		
19		
20		
21		
22		
23		
24		
25		Kavalla – (Καβαλα)
26		Drama – (Δραμας)

27		Kilkis – (Κιλκις)
28		Serres – (Σερρες)
29		
30		
31		
32	Komisi (Κοιμηση)	
33	Paradimi (Παραδημη)	Rodopi – (Ροδοπης)
34	Kipseli (Κυψελη)	Ksanthi – (Ξσανθης)

Vendbanimet ku flitet ende gjuha shqipe, 2013

	Vendbanimet ku flitet ende gjuha shqipe, 2013	**Numri i banorëve, regjistrimi, 2011**	**Prefekturat**
1	Lehova (Λεχοβα)	1.115	Florina
2	Drosopigi (Δροσοπηγη)	239	
3			
4			
5			
6			
7			
8			Thessaloniki
9			
10			
11			Evros
12			
13			
14			
15			
16			
17			
18			
19			
20			
21			
22			
23			
24			
25			
26			
27			
28			

29			
30			Ksanthi
31			
32			
33			
34			Kavalla
35			Drama
36			Kilkis
37			Serres
38			
39			
40			
41			
42	Paradimi (Παραδημη)	434	Rodopi

PASTHËNIE

Nga të gjitha këto sa u tha më lartë vërehet se gara midis grekëve, serbëve dhe bullgarëve për zotërimin e Maqedonisë ishte e ashpër. Popullsitë e tjera që nuk i përkisnin këtyre etnive si shqiptarët, vllehët, hebrenjtë, ciganët, ndodheshin nën presione të vazhdueshme. Vllehët të shpërndarë nëpër Maqedoni, nuk banojnë nëpër fshatra zinxhirë si shqiptarët. Vllehët e Maqedonisë Gjeografike, ishin përqendruar më shumë rreth Edesës, Kosturit, Korçës, Krushevës, Manastirit. Por midis fshatrave vllehe ndodhen fshatrat serbe, bullgare, greke dhe shqiptare, kështu ata mbeten të pa organizuar dhe janë të dënuar të asimilohen, të jenë qytetar të denjë në shtetet ku jetojnë. Gara për të përvetësuar etnitetin vllehe vazhdon edhe sot. Të shpërndarë në disa shtete si Bullgari, Serbi, Maqedoni, Greqi, Shqipëri, ata nuk kanë mundur të krijohen si grup i veçantë etnik, por kanë mbetur popullsi që hyn në grupin e pakicave folklorike. Prej shekujsh grekët propagandojnë se vllehët kanë ndërgjegje greke, janë grek latin, por e vërteta është se vllehët janë vlleh, një popullsi që përcaktimin kombëtar e marrin nga shteti ku jetojnë. Vetëm në Shqipëri vllehët e kanë ndier veten të sigurt nga mos asimilimi i dhunshëm shtetëror. Me interes është fakti se ata kanë bërë martesa me shqiptar ortodoks, katolik dhe mysliman, ndërsa janë shumë të rralla martesat midis vllehëve me minoritarët grek në Shqipëri. Për fatin e tyre të keq sot kanë mbetur pas në zhvillimin e kulturës së tyre etnike. Dikur kjo popullsi kishte Akademi, shkolla në gjuhën e saj, ishin mjeshtër të zbukurimit të kishave me ikona, argjendar me emër, etj.,

ndërsa sot nuk kanë mundur të hapin qoftë edhe një shkollë shtetërore në vendet ku jetojnë në gjuhën e tyre. Vllehët kanë dhënë një kontribut të çmuar në kulturën kombëtare shqiptare, ata gjithnjë e kanë ndier veten më afër me shqiptarët se sa me kombësitë e tjera në Ballkan.

Romët (ciganët) mbeten gjithnjë njerëzit që i shërbejnë më të fortit me të gjitha mënyrat e tyre. Pas kaq vitesh janë problem kulturor në Evropë edhe pse jepen shumë financa për arsimimin e tyre, ata mbeten përsëri një shoqëri e ulët në shtetet ku jetojnë. Shpeshherë kanë qenë viktimë e dhunës raciste dhe policore edhe në shek. XXI, duke i shpërngulur disa herë nga barakat e tyre.

Sllavët, serbët dhe bullgarët e Maqedonisë pasi zgjeruan shtetet e tyre filluan spastrimet etnike kundër popullsive tjera të pambrojtura. Historikisht serbët gjithnjë prodhuan luftëra dhe dhunë mbi popullsitë e tjera që jetonin në Serbi dhe në ish-Jugosllavi. Pas kaq vitesh populli serb ende vazhdon të mendojë për luftëra si në shekujt e kaluar.

Popullsia bullgare që mundi të mbijetojë në Greqi dhe në Republikën e IJR Maqedonisë u asimilua ose u largua për në shtetet e Evropës. Dikur ato fshatra dhe qytete që njiheshin historikisht të banuara nga popullsia bullgare, sot në to nuk gjen një qytetar që me krenari të deklarohet bullgar. Në Maqedoninë Gjeografike ku deri në fillim të shek. XX nuk ekzistonte popullsi të etnitetit maqedonas, pas shumë luftërave dhe propagandave serbe dhe greke është krijuar një komb artificial me emrin maqedonas që po bëhet shkak i një lufte të hapur politike dhe mediatike që ndoshta nesër do të prodhojë luftë ashtu si dikur.

Hebrenjtë pas Luftërave Ballkanike dhe Botërore u masakruan dhe u dëbuan nga territori i Ballkanit. Pothuajse rreth 98% e popullsisë hebre që banonte në Greqi u përzu gjatë qeverisë kuislingë greke, e cila bashkëpunoi me nazistët

gjermanë gjatë Luftës së Dytë Botërore. Pjesa më e madhe e hebrenjve që jetonin në Greqi pas përfundimit të luftës nuk u kthyen më në tokat, shtëpitë dhe pronat e tyre.

Shqiptarët gjatë periudhës së Perandorisë Osmane u dëmtuan më shumë nga të gjithë edhe pse ata përqafuan në masë të madhe islamin. Në dukje shqiptarët gëzonin privilegje në Perandorinë Osmane në krahasim me popujt e tjerë si grekët, serbët, bullgarët, armenët, etj., por në të vërtetë, shqiptarëve, nuk iu lejua pavarësimi i kishës ortodokse, nuk iu lejua hapja e shkollave në gjuhën shqipe, etj. Shqiptarët ishin të fundit që nga Perandoria Osmane iu lejua të themelonin shtetin e tyre të pavarur dhe kjo falë përkrahjes së shteteve si SHBA, Italisë dhe mbretërisë Austro-Hungareze. Turqia për interesat e saja gjithnjë lidhi marrëveshje zyrtare me Greqinë, Serbinë, Bullgarinë dhe Rusinë në dëm të interesave dhe tokave shqiptare. Sot, pas kaq vitesh dhe luftërash qytete dhe fshatra që historikisht janë banuar dhe banohen nga shqiptarët vazhdojnë të jenë pjesë e shteteve si Mali i Zi, Serbia, Greqia dhe Maqedonia (IJRM).

Sjellja ndër vite e refugjatëve nga Azia e Vogël dhe nga ish-Bashkimi Sovjetik që grekët i thërrasin Pondio dhe Ruso Pondios, nga ana e qeverive greke kishte për qëllim asimilimin e popullsive jo-greke që banojnë në Greqi. Nga ana antropologjike, gjuhësore dhe veshja tradicionale refugjatët e ardhur nuk kanë lidhje me qytetërimin antik grek dhe me luftëtarët që themeluan Greqinë Moderne të 1821. Ata më shumë ndihen në zakone si turq dhe sllavë aziatik se sa grek, trashëgimtarë të Sofokliut, Aristotelit, Herodotit, Kolokotronit, Boçarit, Karaiskaqit, Kunduriotit, Pangallos, etj. Këtë shqetësim, për dallimin e racave brenda vetë popullit grek e ka shprehur edhe shkrimtari dhe poeti grek Niko Dhimu në 23 qershor 2009, në gazetën NY TIMES, ku deklaron se: *"Ne flisnim shqip dhe vetëquheshim romaikos, por pastaj "Gëte,*

Viktor Hugo, Delacroix, na tha: "Jo, ju jeni grekë, pasardhës të drejtpërdrejtë të Platonit e Sokratit...". Në qoftë se një vend i vogël, një komb i varfër ka një barrë të tillë mbi supet e tija, ai kurrë nuk do të shërohet..." Siç e deklaron shkrimtari Niko Dhimu, grekët e sotëm nuk janë grekët e lashtë që pretendonte historiani gjerman në shekullin 18 Johann Winckelmann, i cili krijoi vizionin se Greqia e lashtë është populluar nga njerëz të bukur, me flokë të verdhë e të gjatë, njerëz të zgjuar. Ky përfytyrim i Johann Winckelman, në të vërtetë ka lidhje me ilirët të cilët kishin këto karakteristika, pra, ata, grekët e lashtë kanë qenë ilirët dhe jo grekët e sotëm. Popullsitë e Greqisë së shekullit 19, si shqiptarët, sllavët, turqit, hebrenjtë, arabët, vllehët, u imponuan të krijonin identitetin modern grek. Por karakteristikat e këtyre racave, nuk përputheshin me karakteristikat e grekëve të lashtë, përveç shqiptarëve sepse është vërtetuar shkencërisht që ne rrjedhim nga ilirët.

Në mars 2010, redaktori i medies së njohur gjermane "*Frankfurter Alemanje Caitung*", Andreas Kilb në faqen zyrtare të saj publikoi një opinion të tij me titull "*Grekët nuk e kanë origjinën nga grekët*", ku ndër të tjera ai sqaronte se populli grek që njohim sot, nuk është gjë tjetër veç asaj që lanë pas sllavët, frëngët kryqëzues, bullgarët, serbët, katalanasit, osmanët dhe shqiptarët. Madje Kilbi tenton të hetojë edhe aspektin psikologjik të popullit grek, duke përfunduar se ndryshimi nga origjina zëvendësohet me solidarizimin e vazhdueshëm për t'u përballur me një armik të përbashkët. Ai thekson se në çdo të katërtin grek, një është refugjat, kaq të tjerë kanë origjinë sllave, por të gjithë janë të bashkuar kundrejt armikut të përbashkët. Greqia ka qenë e pushtuar nga sllavët të cilët u ndalën dhe u tërhoqën pasi ndeshën në rezistencën e fortë të shqiptarëve në Athinë të udhëhequr nga Gjin Bue Shpata. Ajo ka qenë e pushtuar edhe nga bullgarët, kryqëzata frënge, katalanasit dhe në përfundim të 1450 nga Perandoria

Osmane. Por, gjithnjë këta pushtues të Greqisë janë ndeshur me fiset shqiptare të cilët jetonin që në lashtësi në Thesali, Boeotia, Peloponez dhe ishujt e shumtë. Kjo vërtetohet edhe nga fakti se shumica e kapedanëve të Kryengritjes së 1821, ishin shqiptarë dhe për disa vite shqiptarët drejtuan Greqinë e Re në të gjitha fushat, Kryetar shteti, Kryeministra, Akademikë, etj.

Në Maj të vitit 2012, shkrimtari grek Dimitris Epikouris në një shkrim të tij për grekët do të shkruante: "*Greqia moderne nuk ka asnjë nyje që e lidh atë me Greqinë e lashtë dhe njerëzit që dikur jetonin në atë vend, e parë kjo si në aspektin kulturor, ashtu dhe në atë gjenetik. Grekët e sotëm janë një mishmash i fiseve ballkanike, (shqiptarë, sllavë, vllahë) të cilët gjatë periudhave të ndryshme kohore u përzien gjithashtu me afrikano-veriorë, Armeninë dhe fise të tjera të Anadollit, pa harruar të përmendim këtu dhe frankët me venedikasit të cilët ishin po ashtu të shumtë në atë rajon*".

Ndërsa poeti i madh grek i vlerësuar me çmim Nobel në letërsi më 1979 Odysseas Elytis ka shkruar: "*Atdheu im, një mural i mbajtur prej shtyllave franceze, shqiptare, vllahe e turke. Kushdo që i përmend, shkon drejtë e në burg*".

E përfundova në Korrik 2013

BURIME DHE LITERATURA

Hartë Etnografike
DEMOGRAFIA E VISEVE SHQIPTARE NË GREQINË E VERIUT
Zonat ku ishte folur gjuha shqipe deri në vitë 1913
Zonat ku flitet emdo gjuha shqipe 2013
Autori Arben Llalla
Korrik, 2013
Copyright©Autori

PASQYRA E LËNDËS

PARADHËNIE…….....…….5
HYRJE.....9

KAPTINA I
ORIGJINA ILIRE-SHQIPTARE E ALEKSANDRIT TË MADH.....21
Filipi II.....21
Olimbia.....23
Aleksandri i Madh.....24
Elementët që tregojnë origjinën ilire-shqiptare të Aleksandrit të Madh.....27

KAPTINA II
TË DHËNA MBI POPULLSINË E PJESËS EVROPIANE TË PERANDORISË OSMANE.....29

KAPTINA III

BIOGRAFITË E DISA STUDIUESVE QË JANË MARRË ME DEMOGRAFINË E POPULLSISË NË MAQEDONINË GJEOGRAFIKE.....37
Nikolaos Th. Shina, (1844-1912).....37
Vasili Kënçov (1862-1902).....38
Dimitar Mishev-Brancoff (1856-1932).....40
Athanasios Halkopulos (1881-1939).....41
Borivoje Millojeviç (1885-1967).....42
Dhimitri Lithoksu (1954-).....43

KAPTINA IV
KAZAJA - PREFEKTURA E KOSTURIT
Qyteti i Kosturit.....45
Fshatrat shqiptar të prefekturës së Kosturit.....51

KAPTINA V
KAZAJA - PREFEKTURA E FOLLORINËS
Qyteti i Follorinës.....67
Fshatrat shqiptar të prefekturës së Follorinës.....73

KAPTINA VI
TË DHËNA PËR SHQIPTARËT NË PREFEKTURAT E SELANIKUT, EDESËS, VERIAS DHE GREVENAS
Qyteti i Selanikut.....103
Dorëzimi i Selanikut nga gjenerali turk me kombësi shqiptare grekëve.....108
Vrasja e Hasan Prishtinës në Selanik.....112
Të dhëna për Selanikun dhe fshatrat ku banojnë shqiptarët.....117
Të dhëna për shqiptarët në qytetin e Edesës.....122
Të dhëna për shqiptarët në qytetin e Verias.....123
Të dhëna për shqiptarët në Prefekturën e Grevenas.....123

KAPTINA VII
FSHATRAT SHQIPTAR NË PREFEKTURAT E EVROS, RODHOPIT DHE KSANTHIT.....125
Fshatrat shqiptar të Prefekturës së Evros.....131
Bashkia e Aleksandropolit.....131
Komuna Tihero (Tiqero).....132
Komuna e Orestiadhës.....136
Komuna Dhidhimotihu.....137
Komuna e Feron.....138
Komuna Orthea.....140
Fshatrat shqiptarë të Prefekturës së Rodhopit.....141
Fshatrat shqiptarë të Prefekturës së Ksanthit.....141
Komuna Tiperu.....143

KAPTINA VIII
FSHATRAT SHQIPTAR NË PREFEKTURAT E KAVALLËS, DHRAMËS, SERRESIT, KILKISIT
Fshatrat shqiptarë të Prefekturës së Kavallës.....145
Fshatrat shqiptarë të Prefekturës së Dhramës.....147
Fshatrat shqiptarë të Prefekturës së Serresit.....149
Fshatrat shqiptarë të Prefekturës së Kilkisit.....151

TABELAT E TË DHËNAVE.....156

PASTHËNIE.....163

BURIME DHE LITERATURA.....169

PASQYRA E LËNDËS.....185

HARTA

Falenderojmë dashamirësit e kulturës shqiptare që financuan pjesërisht botimin e këtij libri.

z.Bashkim GLLOBOCISHTA
z.Lirim SH.
z.Amet B.

Shënim: Kërkojmë ndjesë për gabimet e shtypit që mund të gjenden aty-këtu në këtë libër me shpresën se në botimin e dytë kanë me u ndreq.